



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 28.09.2015, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektvendim “Për caktimin si anëtarë te Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë të dy përfaqësuesve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
2. Projektvendim “Për miratimin e kërkesës së Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (vendas e ndërkombëtarë), për marrjen e opinionit të Komisionit të Venecias lidhur me projekt-amendamentet dhe çështjet kushtetuese, të hartuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë”.
3. Projektvendim “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit te Posaçëm deri me 30 Qershor 2016”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Spartak Braho, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Jorida Tabaku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Z.Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Znj.Aurela Anastasi – Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Gent Ibrahimimi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Meqenëse kuorumi është realizuar, mund të fillojmë mbledhjen e komisionit të posaçëm parlamentar për Reformën në Drejtësi, sipas rendit të ditës që është shpërndarë paraprakisht dhe që e keni në tavolinë, bashkëngjitur në rrugë elektronike, por edhe sot në tavolinë, keni dokumentet shoqëruese sipas preventivit.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, projektvendimi “Për një shtesë në vendimin numër 7, datë 23.01.2015, të komisionit të posaçëm, i ndryshuar, “Për miratimin e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm parlamentar”. Presidenti i Republikës, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zoti Bujar Nishani, i është adresuar komisionit të posaçëm parlamentar me shkresën e tij, duke i kërkuar që në përbërjen e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, të përfshihen edhe dy ekspertë që do të përfaqësojnë Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe, konkretisht, zoti Dritan Hamitaj, anëtar i KLD-së dhe zonja Marsida Xhaferllari, kryeinspektore pranë Inspektoratit të KLD-së. Ky vendim është në përputhje me atë çfarë ka vendosur Kuvendi në vendimin e krijimit të komisionit të posaçëm parlamentar dhe me taktikën e ndjekur nga ky komision i posaçëm parlamentar, lidhur me formimin e ekspertëve të nivelit të lartë në bazë të përfaqësimit të insioneve të drejtësisë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me të gjitha kërkesat tona të herëpashershme, nuk ka dërguar më parë përfaqësues të tij dhe më së fundi, kryetari ka vendosur të dërgojë dy përfaqësues, konkretisht, siç thashë ka nominuar zotin Dritan Hamitaj dhe zonjën Marsida Xhafellari.

Ka ndonjë gjë për këtë çështje? Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka

Miratohet.

Pra, shtohen dy anëtarë të rinj, përfaqësues të institucionit të KLD-së, në përbërje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe kështu grupi i ekspertëve të nivelit të lartë konsiderohet i plotë, edhe me këtë mungesë të ndjeshme të tij gjatë këtyre 9 muajve.

Po, zoti Halimi, për procedurë për rendin e ditës.

Eduard Halimi – Tani, zoti Xhafaj, ne jemi njoftuar ditën premte, në përfundim të orarit zyrtar, duka na çuar *email*, se ekspertët e nivelit të lartë kanë përfunduar amendamentet.

Së pari, e caktuat mbledhjen, caktuat rendin e ditës për një komision që është ngritur në bazë të konsensusit dhe me përbërje të barabartë, pa u konsultuar me nënkryetarin, siç funksionon çdo komisionin normal i përhershëm, apo edhe i posaçëm, për të caktuar orën, datën e me radhë të gjitha të tjerat.

Sigurisht, që hartimi në mënyrë të njëanshme, qoftë i rendit të ditës, qoftë edhe i gjithë materialit të amendamenteve kushtetuese nga ekspertët vendas të propozuar nga ju, të emëruar nga ju, duke mos thirrur në asnjë moment, duke mos u konsultuar fare me ekspertët e propozuar nga PD-ja, edhe pse unë gjatë muajit gusht ju kam dërguar dy shkresa, juve dhe ekspertëve, bashkëkryetarëve të grupeve, që ekspertët tanë janë këta, diskutoni me ta çdo draft që do të përgatitsni, në mënyrë që në atë produkt të jetë edhe opinioni i opozitës, gjëja më normale që duhet të ndodh në një reformë, që nuk ka të bëjë me një mandat qeverisës, por mendojmë që të jetë një reformë afatgjate, që t'i shërbejë sistemit, të luftojë pa kompromis korrupsionin, por ta mbajë edhe të pavarur nga politika.

I gjithë ky proces, jo se unë nuk prisja, apo nuk e kuptoja, nuk jam naiv, por këto janë hile të vogla: cakto rendin e ditës, bëj draftin, nxirre draftin ditën e premtë dhe mos i lerë kohë për t'u shprehur, ky është një proces i cili e minon konsensusin. Ne patëm edhe parë, për hir të së vërtetës, një diskutim sipas të cilit ne kemi propozuar që drafti i përgatitur prej jush, i sjell në këtë rend dite, të përcillet në Komisionin e Venecias, sepse jemi ne që kemi kërkuar që patjetër që do të shprehet Komisionin i Venecias për gjetjet, por këtij drafti t'i bashkëngjiten në mënyrë të padiskutueshme edhe komentet e opozitës, edhe impakti, edhe produkti që ka opozita, në mënyrë që Komisioni i Venecias ta shohë qëndrimin që ka grupi juaj, por të shohë edhe qëndrimin që ka opozita, në mënyrë që kur të shprehen, të kenë të qartë panoramën se çfarë ndodh. Sigurisht, nuk do të shprehen në një ditë, por do të ketë edhe diskutime të tjera. Ky është proces normal që i shërben konsensusit, sepse ne kemi dyshime të forta, se në këtë dokument ekspertët vendas kanë bërë përcaktime të tilla, të cilat shkojnë në drejtim të kapjes së sistemit të drejtësisë. Disa prej tyre janë në konflikt interesi, sepse kanë konkurruar dhe konkurrojnë për ato vende. Ne i njohim dhe i dimë.

Fatmir Xhafaj – Për procedurë, të lutem!

Eduard Halimi – Për procedurë e kam.

Prandaj, për t'i vënë fre këtij procesi, por edhe për t'i shërbyer konsensusit, unë propozoj që ky draft, që kanë sjellë ekspertët, të mbahet një javë, asnjë ditë më shumë, të merret

vendimi që ditën e hënë, më datë 5 tetor, në orën 12:00, ky draft i përgatitur nga ju, t'i nisët Komisionit të Venecias bashkë me propozimet, me komentet që ka opozita për këtë draft, i cili krijon për opozitën, në një vlerësim paraprak, krijon idenë e kapjes së sistemit të drejtësisë dhe vënies në kontroll të këtij sistemi. Por, për 48 orë gjatë fundjavës, nuk besoj se ka ndonjë ekspert, askush besoj, që për 48 orë, edhe gjatë kohës së pushimeve, të ketë një vlerësim dhe të bëjë 53 amandamente, që janë paraqitur aty. Ky është propozimi im procedural, pastaj flasim për gjëra të tjera.

Fatmir Xhafaj – Dakord,

Vazhdojmë, atëherë. Mund ta diskutojmë këtë gjatë pikës së dytë të rendit të ditës, sepse kjo është pjesë që i takon rendit të ditës. Mendoj se nuk jeni i saktë në atë që thatë:

Së pari, drafti nuk është sjellë prej nesh, por është sjellë prej grupit të ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtar, të cilët janë sot këtu dhe mund të na thonë nëse kanë qenë nën influenca partiake apo politike, nga ato që ju amendësuat.

Së dyti, ka ardhur ditën e premte dhe sapo ka ardhur, 2 orë më pas u është shpërndarë të gjithë deputetëve, në mënyrë të njëjtë dhe në mënyrë të njëkohshme dhe me të njëjtin email. Janë njoftuar deputetët, ata që janë mundur të kontaktohen në telefon, përfshi edhe ju personalisht, që të kishin dijeni për *emailin* e ardhur.

Për sa u përket komenteve që ju keni, lidhur me përmbajtjen, që me këtë draft të sjellë nga ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, po synohet të kapet sistemi e të tjera si kjo, le ta bëjmë objekt debati. Keni të drejtën tuaj të mënyrës se si i shikoni gjërat, që t'i komentoni.

Fillojmë me shqyrtimin e pikës së dytë, “Për shqyrtimin e kërkesës së grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, për marrjen e opinionit të Komisionit të Venecias lidhur me projektamendamentet dhe çështjet kushtetuese”.

Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka paraqitur një grup amendamentesh kushtetuese, së bashku me relacionin shpjegues dhe për të cilat ai i kërkon komisionit të posaçëm parlamentar dhe përmes tij, Kuvendit të Shqipërisë, që t'ia përcjellë Komisionit të Venecias për të pasur një opinion zyrtar rreth këtyre propozimeve dhe komenteve që janë paraqitur prej tyre.

Kjo është një praktikë që është ndjekur në Kuvend. Është i freskët rasti i dekriminalizimit, ku është ndjekur kjo procedurë. Mendoj se grupi i ekspertëve është në të drejtën e tij që ta kërkojë këtë gjë, për të parë nëse ato çfarë ai gjykon dhe çmon, përputhen me standardet ndërkombëtare dhe, në këtë rast, me standardet që ka aplikuar Komisioni i Venecias

dhe për të reflektuar për këto standarde, për këtë opinion, për të kaluar më pas në një draft final që do t'i paraqitet këtij komisioni, ku të gjitha palët që janë përfshirë në këtë proces, janë të lira të diskutojnë, të negociojnë dhe të arrijnë në një draft final që do t'i përcillet Kuvendit për shqyrtim dhe për miratim. Është me pak fjalë, që të mos bëj komente mbi atë që do të duhet të bëjnë vetë përfaqësuesit e grupit të ekspertëve, kështu që unë po ua kaloj fjalën atyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, e mbyllëm çështjen e procedurës. E bëtë një procedurë. Nuk mund t'i imponohesh...

Eduard Halimi – Do të bëj procedurën një herë, pastaj vazhdojmë me ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Eduard Halimi – Ne këtu...

Fatmir Xhafaj - Ka një kufi edhe të flasësh. Ti e di! Ka një kufi!

(Diskutime pa mikrofon.)

Foli një herë. Për procedurë një herë flitet.

Eduard Halimi – Nuk ma tregon dot vendin ti!

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, mbajeni gojën edhe ai, edhe ju! Mos bëni komente!

Eduard Halimi – Për procedurë! Ky komision ka bërë një mbledhje më 27 korrik. Është kështu, apo jo?! Në atë mbledhje është miratuar nga ana juaj në mënyrë të njëanshme draft-strategjia në parim dhe sipas vendimeve që ka marrë parlamenti dhe ju këtu, hartimi i amendamenteve fillon pasi të miratohej strategjia. Ju nuk e keni miratuar strategjinë. Kush u dha urdhër ekspertëve që të fillojnë me draftet? Ja pra, kjo është!

Prandaj unë insistoј të marrim një vendim për këtë çështje. E dorëzuan ekspertët. Ta marrim, ta dëgjojmë, ta analizojmë dhe pas një jave t'ia dërgojmë. Duhet shprehur për këtë gjë. Ditën e hënë në iks datë dhe në iks orë do t'i nisët Komisionit të Venecias, sepse të më thuash që ekspertët ndërkombëtarë kanë thënë që në sistemin gjyqësor nuk do të vijnë ata, që detyrimisht kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës... pra, të heqësh këtë filtër e të më thuash e kanë thënë ekspertët ndërkombëtarë, këtë nuk mund ta pranojë kurrë. Nuk e thonë ata. Këta janë gishtat e ekspertëve vendas, që janë ulur...

Fatmir Xhafaj – Dakord. T'i dëgjojmë ekspertët!

Eduard Halimi – Janë gishtat e tyre që thonë jo nga Shkolla e Magjistraturës, por nga ata të cilët kanë mbi 20 vjet që kanë mbaruar. Kush janë ata? Këtë po të them për procedurë

Fatmir Xhafaj – Cila është për procedurë?

Eduard Halimi – Për procedurë po të them, të marrim një vendim për këtë çështje.

Fatmir Xhafaj – Vendimi merret pasi diskutohet çështja.

Eduard Halimi – Merr vendim për procedurë.

Fatmir Xhafaj – Jo, unë jam kundër vendimit tuaj!

Eduard Halimi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është pro?

Eduard Halimi - Ja, ka pro për këtë.

Fatmir Xhafaj – Kush është kundër? Bie proceduralisht

Vazhdojmë me shqyrtimin e çështjes.

Kush e do fjalën për ta paraqitur?

Zoti Smibert, urdhëroni!

Jon Smibert – Të nderuar anëtarë të komisionit,

Zyra e OPDAT-it e ambasadës amerikane ka pasur privilegjin të marrë pjesë në procesin e reformës në sistemin gjyqësor në Shqipëri, së bashku me ekspertët e nivelit të lartë, kolegë nga misioni EURALIUS, prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe nga kolegë të tjerë.

Dokumenti strategjik u rishikua jo vetëm nga ekspertët e OPDAT-it dhe të EURALIUS-it, por edhe nga zoti James Hamilton, i cili është një ekspert me përvojë i Komisionit të Venecias. Puna në këtë reformë ka qenë e përbashkët midis ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve shqiptarë. Të gjitha komentet dhe këshillat tona janë reflektuar në përmbajtjen e dokumenteve që janë prodhuar.

Ky nuk ka qenë një proces dhe një reformë false. Absolutisht! Ka qenë një proces real. Ne kemi bashkëpunuar në mënyrë konstante dhe kemi marrë në konsideratë kuadrin institucional në Shqipëri, rrethanat si të edukimit të institucioneve dhe kemi bashkëpunuar me ekspertët lokalë.

Kjo nuk ka qenë një reformë *copy-paste*, siç mund të ketë ndodhur në vendet tjera, që janë marrë modelet shabllon, por i është përshtatur kontekstit shqiptar. Janë propozuar zgjidhje, të cilat u përshtaten rrethanave shqiptare dhe përpiqen të zgjidhin problematikat që ekzistojnë në realitetin shqiptar. Duke u bazuar në pozicionin tim specifik, që kam qenë në pozicionin e ekspertit të nivelit të lartë, veçanërisht, për sa u takon çështjeve kundër korrupsionit të sistemit të prokurorisë, ndryshimet që kemi parashikuar përpiqen t'i adresojnë ato probleme emergjente që

ka Shqipëria, për sa i takon sistemit të prokurorisë dhe antikorrupsionit, për të rritur profesionalizimin e prokurorëve dhe për të luftuar korrupsionin.

Për sa i takon korrupsionit është propozuar të ngrihet një strukturë e veçantë i hetimit të korrupsionit, siç është modeli kroat apo rumun dhe fokusohet në krijimin e një prokurorie speciale kundër korrupsionit dhe një gjykatë speciale kundër korrupsionit.

Ka një nen, i cili parashikon krijimin e një këshilli të lartë të prokurorisë, që është një institucion kushtetues dhe do të ketë kompetencat e veta. Duke propozuar krijimin e këshillit ne synojmë t'i japim atij kompetencat, që kanë të bëjnë me rekrutimin me promovimin me disiplinimin e prokurorëve dhe jemi bazuar në mësimet e nxjerra nga vendet e tjera, që kanë përdorur dhe që kanë një këshill të ngjashëm të lartë të prokurorisë, duke u bazuar në parimin për të shmangur korrupsionin për ta luftuar atë, për të luftuar përplasjet e brendshme dhe për të luftuar atë që quhet korporatizmin brenda kësaj strukture.

Gjithashtu, propozohet krijimi i një këshilli të lartë për gjyqësorin, i cili nuk është ndryshimi i emrit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ekzistues, por është një këshill i ri i cili ka një rol të ri që bazohet në modele ndërkombëtare të suksesshme dhe që përpiqet të balancojë dhe të luftojë korporatizmin dhe korrupsionin.

Procesi aktual i inspektimit të gjyqtarëve përfshin shumëllojshmëri të inspektimeve, që u mungon eksperiencave formimi i duhur për të inspektuar gjyqtarët, ne propozojmë krijimin e një inspektorati të pavarur me ndryshimet kushtetuese, pasi mënyra sesi realizohen inspektimet aktualisht nuk është në përputhje me pritshmëritë e standardeve të BE-së. Ky inspektorat i pavarur bazohet në modelin bullgar dhe jo vetëm në modelin bullgar, por edhe në mësimet e nxjerra nga përvoja bullgare.

Një dispozitë tjetër e propozuar është një shtojcë të ndryshimet fokusohet jo vetëm në çështjet e korrupsionit, por edhe në çështjet e profesionalizimit të gjyqtarëve dhe kontrollin në profesionalizimin e tyre.

Masa transitore, të cilat në qoftë se një prokuror apo një gjyqtar nuk performon në standardin e duhur, atëherë ai ose duhet të përballlet me një trajnim të detyrueshëm ose me një shkarkim. Gjithashtu, duhet të ketë kontrole periodike të aseteve dhe aftësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Është menduar të krijohet një komision i përkohshëm, i cili të përfshijë edhe vëzhgues ndërkombëtarë, pra të ketë standarde objektive, një proces të drejtë, pra siç e thamë të ketë edhe vëzhgues ndërkombëtarë.

Ndërkohë, ka edhe propozime të tjera brenda paketës së ndryshimeve. E para, ka të bëjë me ndryshime për sa i takon përbërjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si edhe parashikohet krijimi i një Gjykate të Lartë Administrative. Gjithashtu, ka ndryshime për sa i takon kualifikimit dhe procedurës së emërimit si të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe të Gjykatës së Lartë Administrative.

Kryesore është që të reduktohet korrupsioni dhe influenca politike mbi gjyqësorin.

Jemi shumë në dijeni, që ky proces të mos jetë subjekt i kapjes politike, pra është diçka që ne nuk e duam.

Vlerësimi ynë i fundit është të krijojmë një sistem gjyqësor dhe të prokurorisë, i cili të jetë funksionues, i efektshëm dhe efikas dhe ta çojë Shqipërinë sa më afër Bashkimit Europian.

Në emër të grupit të ekspertëve ku kemi punuar për shumë muaj, ju falënderojmë për mundësinë që na dhatë, që të prezantojmë shkurtimisht një përmbledhje të këtyre propozimeve për ndryshime dhe të lejoj edhe kolegët e tjerë ekspertë nëse kanë diçka për të shtuar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Smibert!

Ndërkohë do të bëjmë 5 minuta pushim! Njëra nga mediat ka kërkuar leje për të futur kabllot për transmetimin live. Kështu që, jemi të detyruar të presim 5 minuta.

Përfaqësuesve të Kuvendit, që merren me mediat, u lutem të ndalojnë kamerat për 5 minuta dhe kush ka dëshirë të transmetojë live, le të fusë kabllot me shpejtësi.

(Mungesë inçizimi).

Fatmir Xhafaj – Kanë mundësi. Rëndësi ka që kamerat janë brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Vazhdojmë. Për procedurë, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Zoti kryetar, unë e shikoj krejtësisht të pavend që mediet të pengohen për ta dhënë *live* këtë seancë, duke gjetur në gjithë këtë godinë të madhe me 5 kate, të vetmin vend ku nuk mund të realizohet lidhja *live*. Ke tre autobusë mediesh që po rrinë jashtë dhe po të thonë se nuk e realizojnë dot këtu, ndërkohë që salla sipër pret vetëm të hapet me çelës dhe të shkojë kabllot. Po pse e keni frikë transmetimin *live*, se pse e keni frikë këtë element komponent të transparencës, unë nuk e kuptoj?!

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Ata kanë gjithë paraditen që presin atje dhe pengohen, thanë gazetarët. Në qoftë se do të kishte pasur ndonjë kërkesë dhe në qoftë se ju vërtet do të kishit dashur transparencën, në gjithë këtë godinë të madhe, ku sot jemi vetëm ne, fare mirë mund të shkoni të hapni sallën e madhe, që hapni sa herë ka komisione edhe më pak të rëndësishme se ky dhe ku mund të realizohet transmetimi *live*.

Fatmir Xhafaj – Qartë.

Gent Strazimiri - Ju lutem shumë, merrni masat e nevojshme për të garantuar transparencën!

Është debati që ndoshta më shumë se çdo debat tjetër i intereson opinionit publik.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Transparenca është e garantuar me prezencën e kamerave këtu. Unë nuk mbaj përgjegjësi se cili e jep *live*, apo cili nuk e jep *live*, ngelet në çmimin e tyre. Mbledhja ka filluar, nuk mund të ndërpres mbledhjen, të ndryshoj sallën, e të tjera. Kjo nuk ndodh. Herë tjetër, nëse ka një pengesë të tillë...

Gent Strazimiri – Nuk u ke krijuar kushtet, zotëri.

Fatmir Xhafaj – Dakord. E rëndësishme është që nuk ka kamera dhe gazetarë që të jenë ndaluar të hyjnë në sallë.

Gent Strazimiri – Ndërpreve mbledhjen tani, që të bëhet lidhja *live*. Po ju thonë që teknikisht bëhet një kat më lart. Pikë.

Fatmir Xhafaj – Sepse mendoja se mund të realizohej, nuk mund të realizohet.

Gent Strazimiri – Bëhet një kat më lart. Të shkojmë ta bëjmë një kat më lart, siç e kemi bërë edhe herë të tjera.

Fatmir Xhafaj – Kamerat janë këtu, kush të dojë t'i regjistrojë, nuk kam absolutisht asgjë, janë të lirë nga mëngjesi deri në darkë. Kjo është detyra ime.

Vazhdojmë mbledhjen. Ka komente të tjera?

Gent Strazimiri – Unë nuk e kuptoj këtë gjë. Pse i vini këtë hije procesit?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Hije ka boll, por të paktën kini kurajën të dalë përpara miletit kjo punë, zotëri.

Fatmir Xhafaj – Qartë.

Gent Strazimiri – Këto argumente që keni zgjedhur, ashtu të sforcuara si i keni zgjedhur, merrini t’i dëgjojnë edhe njerëzit.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Prandaj janë kamerat, do t’i transmetojnë sot, nesër...

Gent Strazimiri – Kamerat po presin poshtë të bëjnë lidhjen *live*.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Është një reformë historike, për të cilën ty vetë të intereson ta tregosh historinë shqiptarëve sot. Pse ua fsheh historinë që po bën, shqiptarëve?

Fatmir Xhafaj – Dakord. Të fshehura janë. Ka ndonjë kamer që mungon këtu, që është ndaluar?

Gent Strazimiri – Ke tre autobusë që tentojnë lidhjen *live* dhe ti u cakton të vetmen sallë të Kuvendit ku nuk bëhet lidhja *live*.

Fatmir Xhafaj – Autobusët unë nuk i fus dot këtu në sallë.

Gent Strazimiri – Jo, kabllin po.

Fatmir Xhafaj – Ua dhashë mundësinë, në qoftë se do...

Gent Strazimiri – Jo, ti e di që këtu nuk bëhet.

Fatmir Xhafaj – Unë nuk jam teknik televizori.

Gent Strazimiri – Unë besoj se ti e ke detyrim ligjor.

Fatmir Xhafaj – Do sherr ti tani?

Gent Strazimiri - E ke detyrim t’i krijosh kushtet medias.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk e kam detyrim. Unë kam detyrim të bëj mbledhje këtu dhe media të jetë prezent.

Gent Strazimiri – Jo të bësh mbledhje kulisash, si jeni mësuar t’i bëni që më 8 nëntor të 41.

Fatmir Xhafaj – Po.

Gent Strazimiri – A është historike? Tregojini popullit historinë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Keni gjë tjetër? Vazhdojmë. Kush është dakord?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*).

Po, vazhdoni.

Eduard Halimi – Kemi thënë se këtë reformë nuk e kemi për vete dhe këtu kemi rënë dakord. Nuk është reformë që duhet ta bëjë politika dhe nuk duhet t’i shërbejë politikës. Kjo reformë duhet t’u shërbejë qytetarëve. Kjo është a-ja, të mos fshihemi kot.

Unë kam 7-8 vjet në këtë sallë dhe ti ke pak më shumë. Të gjithë e dimë, që në këtë sallë transmetimet *live* nuk bëheshin. Nuk e ngritëm ne problemin, shqetësimi na erdhi nga media që nuk po transmetojmë, i kemi të gjitha pajisjet, kemi gjithë ditën këtu që po presim dhe nuk transmetojmë dot. Për këtë arsye, pa e bërë debat mediatik të kërkoja që mediet të transmetonin *live*. E gjithë kjo, sipas informacionit që na jep punonjësja e Kuvendit, është që duhet të ngjitemi lart për transmetim. Po ku ka gjë më... A themi ne nga mëngjesi deri në darkë që kjo është reforma më e rëndësishme për shqiptarët? E themi, apo jo? E themi. Ndërsa tani, këtë proces duhet ta mbajmë fshehur, këtë proces duhet të mos e transmetojmë. Pse? Sepse përtojmë të ngjitemi lart. Pse, sepse është ky? Është shqetësim i drejtë i medias, shqetësim i drejtë i kolegut. E ndërpresim mbledhjen për 5 minuta, ngjitemi lart, qoftë 10 minuta, apo edhe 1 orë po të jetë e nevojshme, në qoftë se mediet e kërkojnë këtë gjë, sepse e kërkuam mediet, nuk e kërkuam ne. Ne ishim duke diskutuar dhe nuk e dinim nëse jepej *live* apo jo. Mediet e ngritën këtë shqetësim dhe thanë se neve na duhet transmetimi *live* dhe nuk na lejon Kuvendi për ta bërë *live*". U zgjidh që nuk i pengonte Kuvendi, i pengonte salla. Problemi ishte vetëm te spostimi. Pse kjo këmbëngulje me arrogancë, po të duan të transmetojnë, po të duan jo? Nuk është oborri jot, ore burrë. E keni shumë gabim kështu. Ndërprite mbledhjen dhe t'u japim mundësi medieve të transmetojnë *live* në një sallë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko - Unë mendoj që bërja e mbledhjes në sallën e Komisionit të Ligjeve është diçka pa paragjykim, sepse ndryshe nuk do të ishim ulur fare për të filluar mbledhjen.

Së dyti, mendoj që diskutimi i sotëm është procedural dhe kishte të bënte me shtimin e dy ekspertëve që u miratuan me konsensus.

Pika e dytë është për dërgimin e materialeve bazë të përgatitura nga grupi i ekspertëve në Komisionin e Venecias.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Qartë. Të vazhdoj?

Pika e tretë, dhe e fundit, do të jetë një projektvendim që do t'ia prezantojmë Kuvendit, që ka të bëjë me shtyrjen e afatit të punës së këtij komisioni deri në datën 30 qershor.

Në këtë moment procedural ne mund të themi disa gjëra. Së pari, materiali që paraqitet nga grupi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe atyre vendas, nuk është një alternativë ose një dokument i Partisë Socialiste apo i maxhorancës, përndryshe aty nuk do të shikonit ekspertizën

ndërkombëtare të fliste, por do të shikonit një përfaqësues të Partisë Socialiste apo të LSI-së, pra të maxhorancës.

Mendoj që kolegët e Partisë Demokratike janë në të drejtën e tyre, ashtu siç kanë bërë, që kanë përgatitur një material paralel gjatë muajit gusht, siç e kanë shprehur, dhe që sot kërkuan të shkojë së bashku me materialin e përgatitur nga grupi i ekspertizës.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Të vazhdoj unë. Mbase ka keqkuptime, por të vazhdoj unë deri në fund, siç e kuptova.

Pra, të dyja materialet të shkojnë në Komisionin e Venecias. Unë mendoj se këtu nuk ka asgjë të keqe. Të dyja materialet, madje edhe ndonjë material tjetër në qoftë se ka, të shkojnë në Komisionin e Venecias. Pse e them këtë? E them, sepse ne nuk po shikojmë mendime fundore. Maxhoranca nuk ka ardhur këtu me idenë që materialin e përgatitur nga ekspertiza ndërkombëtare dhe ekspertët vendas ta përdorin si një fakt të kryer për të shkuar në seancë parlamentare dhe për ta votuar direkt. Mendoj se i duhet shpjeguar publikut, se ne po e fillojmë diskutimin duke e çuar paraprakisht në Komisionin e Venecias, që gjatë rrugës, në çdo rast, në çdo lloj kompromisi që do të bëjmë bazuar në materialet e përbashkëta, të mos detyrohemi t'i rikthehemi edhe një herë Komisionit të Venecias, pasi kemi rënë paraprakisht dakord që, gjithçka ne do ta bëjmë në bashkëpunim me ekspertizën ndërkombëtare dhe me Komisionin e Venecias. Në këtë këndvështrim mendoj se është me vend, që ne sot të orientohemi në diskutimin procedural. Sigurisht, kjo nuk ua heq të drejtën përfaqësuesve të opozitës të bëjnë pyetje, të kërkojnë shpjegime për materialin e ofruar nga ekspertiza ndërkombëtare dhe ekspertiza vendase.

Unë mendoj, duke qenë se opozita ka ardhur me një material të vetin të përgatitur gjatë muajit gusht, mirë do të ishte që ne në vazhdim të kemi një hartë të përbashkët, dalëngadalë, nuk po them që sot ne duhet të biem dakord për të gjitha, por mendoj se duhet të ecim mbi bazën e kësaj procedure. Pra, të shikojmë në Komisionin e Venecias të dyja palët bashkë dhe dalëngadalë të kemi një hartë, atje ku biem dakord dhe atje ku nuk biem dakord. Ka shumë rëndësi, që kur miraton ligjin e Kushtetutës t'i thuash publikut që ne nuk biem dakord në këto pika, sepse këta thonë kështu, kurse ne themi kështu.

Mendoj që në këtë pikë procedurale kryetari i komisionit jua shpjegoi, por mbase është edhe momenti pak i ngarkuar. Ne sot të miratojmë që këto materiale të shkojnë në Komisionin e Venecias. Nëse doni të dini opinionin tim, ne nuk jemi të bllokuar që ta aktivizojmë tani

Komisionin e Venecias dhe të mos e riaktivizojmë më vonë kur ne të jemi në një fazë tjetër të diskutimeve. Por, është e nevojshme tani për momentin, që gjithë materialet që kemi bërë dhe kush dëshiron të ofrojë materiale për këtë çështje, t'i drejtohen Komisionit të Venecias.

Ne si maxhorancë jemi në përkrahje të procesit të nisur nga grupi i ekspertizës ndërkombëtare dhe i ekspertëve vendas. Ju keni përgatitur një material tuajin, është e drejta juaj, por mendoj se të dyja palët sot duhet të bien dakord në këtë pikë, që materialin bazë të krijuar nga të dyja palët ta çojmë në Komisionin e Venecias, të dëgjojmë opinionet e tyre dhe më pas të diskutojmë ku biem dhe ku nuk biem dakord.

Mendoj se ne mund ta rakordojmë, sepse po diskutojmë procedurë dhe jo opinione, po diskutojmë ndryshimin e Kushtetutës. Ne e diskutojmë sot këtu sikur kjo Kushtetutë mund të votohet nesër nga maxhoranca dhe ju do të shikoni si do të miratohet në Kushtetutë. Ne nuk e bëjmë dot këtë, sepse Kushtetuta do të miratohet nga votat tona dhe tuajat, kështu që nuk kemi pse e mbingarkojmë diskutimin edhe këtu në komision me idenë se dikush do t'ia bëjë fakt të kryer palës tjetër. Nuk e bëjmë dot, edhe po të mundemi, sepse në fund matematika do të na detyrojë që të ballafaqohemi me këtë fakt, që duhet ta miratojmë të dyja palët së bashku.

Ndaj mendoj se nuk kemi pse e mbingarkojmë situatën, ne mund të biem dakord pikërisht për këtë fakt, që të dyja palët. Ne do ta përkrahim materialin bazë padiskutim, ashtu siç tha edhe drejtuesi i komisionit, dhe kjo ka qenë linja jonë, ekspertiza ndërkombëtare dhe ekspertët vendas, ju keni një linjë tjetër. Por kjo nuk na bllokton ne në një fazë të mëvonshme, që të ulemi dhe të diskutojmë ato gjëra që na bashkojnë dhe ato që nuk na bashkojnë.

Faleminderit!

Gent Strazimiri – Zoti Majko, nga të pranishmit këtu në sallë, unë besoj se ju jeni ndër të vetmit, për të mos thënë i vetmi, që keni marrë pjesë në përpilimin e të vetmit ligj që flet në emër të popullit. Realisht, ligji i popullit është Kushtetuta.

Kur është bërë Kushtetuta që ne kemi sot, po guxojmë ta ndryshojmë, ju keni qenë një ndër personat që e ka përpiluar. Është i vetmi ligj në çdo sistem ligjor që fillon me: “Ne, populli...”, në rastin konkret “i Shqipërisë, krenar dhe të vetëdijshëm...” dhe siç vijon.

E vetmja gjë që po kërkojmë, dhe unë besoj që e kemi këtë detyrim, është që të mjerit popull t'i tregojmë sot që te ligji i vetëm, ku shkruhen të drejtat e tij (janë të paprekshme), po ndërhyjmë 53 herë. A ka mundësi që populli ta marrë vesh *live* që ne po ndërhyjmë 53 herë?

Fatmir Xhafaj – 58 herë.

Gent Strazimiri – 53, e kemi numëruar. 58 e ke? Qenkan edhe pesë të tjera.

Fatmir Xhafaj – Nuk e keni lexuar mirë materialin, e keni në faqet e fundit.

Gent Strazimiri – I mjeri popull duhet ta marrë vesh *live* që ne po ndërhyjmë 58 herë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ende, në 250 e ca vjet, nuk kanë ndërhyrë.

Ne e bëjmë këtë sot dhe ju thoni: “Jo, ne nuk e dimë, e kanë bërë ekspertët”, ndërkombëtarë a kombëtarë, nuk ka rëndësi, por populli ta marrë vesh pas Komisionit të Venecias. A ka mundësi ta ndërpresim këtu këtë punë? Populli ta dëgjojë këtë punë. Po ndërhyjmë tek i vetmi ligj, që është i popullit, dhe nga ku burojnë pastaj të gjitha ligjet e qeverisë.

A ka mundësi tani të krijojmë kushtet që populli të na dëgjojë se po ndërhyjmë 53 herë në të vetmin ligj, që është i tij? E para.

E dyta, të gjitha këto që ju thatë le t’i diskutojmë në sy të popullit kur të jemi *live*, jo këtu në kulisa, jo duke bërë sikur nuk e dimë çfarë kanë bërë ekspertët, se janë ndërkombëtarë, kombëtarë ose të pavarur. Nuk më impresiononi me asnjë nga këto kamufлаzhe që bëni.

Thelbi është ky: përpara popullit, me transparencë, 58 herë thotë zotëria, por, në fakt, 53 herë janë këtu; pesë të tjerat i paskeni në mendje, a ka mundësi të merret vesh se çfarë po bëjmë ose më saktë se çfarë keni bërë? Këtu fillon A-ja, pastaj vazhdojmë me të tjerat.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, vazhdojmë. Ka pyetje për...?

Arben Ristani – Si u vendos?

Fatmir Xhafaj – Do të vazhdojmë mbledhjen.

(Deputeti Strazimiri ndërhyr pa mikrofon.)

Mbledhja është e hapur, sipas Rregullores, media është e pranishme, mbledhja po regjistrohet dhe procesverbal do të ketë. Kështu që vazhdojmë mbledhjen.

(Deputeti Braho ndërhyr pa mikrofon.)

Zoti Braho, ju lutem, për këtë temë jo! Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për këtë të medies.

Spartak Braho – ...mbledhja është e hapur.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje një herë, se mos ka ndonjë pyetje? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Sa ekspertë dhe për sa kohë e kanë përgatitur këtë material që kemi ne përpara?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ristani!

Ju lutem, një përgjigje.

Po, zoti Sadushi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Profesori yt është, dëgjoje të paktën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thuaje me zë të lartë!

Po, zoti Sadushi, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, më vjen keq!

Sokol Sadushi – Përshëndetje!

Unë jam bashkënkryetar i Komisionit për Reformën Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese. Sigurisht, kjo është një punë shumë mujore dhe produkti që ju keni sot është finalizimi i një pune pothuajse tetë mujore. Grupi është detyruar të punojë me intensitet të plotë për një periudhë pothuajse dymujore për të hartuar amendamentet kushtetuese, por pjesa më e rëndësishme është hartuar pasi është miratuar nga ana juaj analiza e gjetjeve dhe kur në parim është miratuar strategjia. Pra, nga fundi i korrikut dhe në vijim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sokol Sadushi – Për sa i përket numrit të ekspertëve, unë jo pa qëllim e fillova diskutimin tim duke thënë: “Unë jam bashkënkryetar i Komisionit për Reformën Kushtetuese”. I gjithë produkti ka marrë aprovimin e të gjitha grupeve në fund të muajit korrik. Grupi, që unë bashkëdrejtoj së bashku me zotin Rainer, ishte i detyruar që t’i paraprinte të gjithë procesit, sepse në qoftë se nuk hartoheshin të gjitha këto projekte të gjitha grupet e tjera do të ishin të bllokuara.

Nga kjo pikëpamje, ne si grup kemi punuar në mënyrë intensive dhe kemi hartuar këto dispozita, të cilat kanë konsensusin e të gjithë grupit të ekspertëve të nivelit të lartë në opinionin mbizotërues që ata kanë dhënë për çdo opsion.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Edhe një pyetje: Me vendim të këtij komisioni ne caktoam disa ekspertë të tjerë. A ju është bërë e ditur? A është konsultuar gjë me ta? Në rast se po ose jo, pse?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Sadushi.

Sokol Sadushi – Kjo është një punë e bërë nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë dhe të gjithë këta ekspertë, duke më përfshirë mua të parin, kemi dhënë kontributin tonë dhe kemi shkruar këto dispozita.

Ajo që thoni ju lidhet me sekretarinë teknike, e cila i ka përfunduar punët e saj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Eduard Halimi – Kam unë pyetje.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Zoti Sadushi, ju jeni njohur me vendimet e këtij komisioni, apo jo? Me vendim të këtij komisioni është miratuar, dhe unë jua kam çuar me ftesë dhe *email* gjatë muajit gusht, edhe zotit Rainer, që ekspertët e propozuar nga opozita, e theksoj, me vendim të komisionit, të përcjellë nga zoti Xhafaj, janë ekspertë pranë grupit të ekspertëve të nivelit të lartë. Ju e dini këtë gjë, apo zoti Xhafaj nuk jua ka vënë në dijeni?

Sokol Sadushi – Sigurisht që unë jam në dijeni, ashtu siç janë në dijeni të gjithë që...

Eduard Halimi – Nuk janë sekretarë teknikë. Komisioni nuk ka marrë vendim për sekretarë teknikë.

Sokol Sadushi – Më lejoni, i nderuar zoti deputet, t'ju them se ata që ju përmendni nuk janë të miratuar si ekspertë të nivelit të lartë.

Po flas në emrin tim dhe në emër të ekspertëve të nivelit të lartë. Ekspertët e nivelit të lartë nuk janë përjashtuar nga ky proces dhe unë këtu, së bashku me kolegët, jam për të thënë që ky material ka dalë nga ekspertët e nivelit të lartë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

(Diskutime në sallë pa mikrofon.)

Para së gjithash, do të doja t'ju falënderoja për punën voluminoze që keni bërë, por njëkohësisht për të shprehur se me këtë prezantim të amendimeve kushtetuese ju sillni një sërë risish shumë të rëndësishme dhe që pa dyshim kërkojnë edhe opinionin e Komisionit të Venecias.

Unë kam dy pyetje lidhur me projektin që ju keni paraqitur.

Ndërkohë që ne do të miratojmë sot dërgimin e këtyre amendimeve së bashku me materialin shpjegues, për të marrë opinionin e Komisionit të Venecias, a mendoni se do të bëni konsultim publik të tyre, apo do të jeni në pritje të opinionit të Komisionit të Venecias?

Pyetja e dytë ka të bëjë me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Në materialin shpjegues ju bëni një sqarim shumë të saktë dhe të qartë të vështirësisë ose të problematikave që kanë këto procese në shumë vende, por njëkohësisht sillni edhe përvojën e Komisionit të Venecias.

Mua më duket një praktikë që nuk e kam parë dhe as lexuar, ndaj më lind pyetja: keni pasur ndonjë model nga i cili jeni udhëhequr për të bërë këtë vlerësim ose rivlerësim të punës së gjyqtarëve dhe të prokurorëve?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet?

Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Faleminderit, zonja Hysi!

Në lidhje me pyetjen tuaj për procesin e konsultimeve, në fakt, vendimet për procesin deri tani janë marrë nga komisioni dhe ne thjesht i kemi ekzekutuar ato. Besoj se kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Për sa i takon pyetjes suaj për thelbin e procesit të vlerësimit, besoj se zoti Smyber mund të bëjë opozitë më të mirë se unë për t'iu përgjigjur.

Fatmir Xhafaj – Zoti Smibert, ju lutem, një përgjigje për pyetjen e dytë!

Jon Smibert – Faleminderit!

Për sa i takon verifikimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, po marr eksperiencën time në Kosovë në lidhje me këtë procedurë që zhvillohej atje për prokurorët dhe gjyqtarët.

Procesi në Kosovë ishte një eksperiencë unike, për shkak të shpalljes së pavarësisë, dhe kishim të bënim me një shtet të ri, por në aspektin praktik ka shumë mësim për t'u nxjerrë nga përvoja kosovare.

Struktura e procesit të verifikimit në Kosovë bazohej në një sërë vendimesh të Komisionit të Venecias sa i takon Ukrainës. Ndërkohë, propozimi që ne kemi paraqitur bazohet në eksperiencën kosovare edhe në Serbi, megjithëse aty u refuzua nga Gjykata Kushtetuese, për arsye që këtu nuk është vendi të diskutohen, dhe propozimit që iu bë nga qeveria e Ukrainës, në bazë të të cilit doli një vendim shumë i detajuar i Komisionit të Venecias.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Smibert!

Ka pyetje të tjera? Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kam një pyetje për zotin Rainer.

Bashkëkryetari juaj shqiptar juaj shqiptar deklaroi tani se nuk i ka thirrur ekspertët e propozuar nga PD-ja, sepse sipas tij, ata janë te Sekretariati Teknik. Unë jam nënkryetari i këtij komisioni.

Fatmir Xhafaj – Ai nuk tha që ata janë te Sekretariati Teknik. Ai tha që nuk janë ekspertë të nivelit të lartë.

Eduard Halimi – Po, ashtu tha. Këta janë shumë superekspertë, por tani po pyes zotin Rainer, nëse është njohur me vendimin e këtij komisioni që ekspertët e propozuar nga PD-ja janë ekspertë pranë grupit të nivelit të lartë? A e keni marrë këtë vendim? Bashkëkryetari juaj shqiptar thotë diçka tjetër. Ai thotë që janë te Sekretariati Teknik.

E dyta, a mund të kem një përgjigje edhe nga ju, se cila është arsyeja që ekspertët shqiptarë nuk janë përfshirë? Është kjo që thotë bashkëkryetari juaj shqiptar, apo është një arsye tjetër?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Kjo pyetje është personalisht për zotin Rainer. Urdhëroni, zoti Rainer!

Zoti Deville!

Rainer Deville - Përshëndetje të gjithëve!

E vlerësoj shumë dhe jam shumë i kënaqur që sot jemi duke diskutuar draft-amendamentet e Kushtetutës që janë paraqitur sot.

Ky propozim thjesht hap diskutimin. Nuk votojmë ndryshimet zyrtare të Kushtetutës sot. Ato nuk janë përfundimtare, por janë thjesht propozime.

Sot thjesht po kërkojmë të pyesim Komisionin e Venecias për idetë që kemi hedhur në draft-propozimet kushtetuese dhe në materialin shpjegues të këtyre propozimeve.

Nuk shikoj dhe nuk gjykoj se ka arsye që ne të mos t'i drejtohem Komisionit të Venecias dhe të mos t'i kërkojmë mendim, pasi e dimë që ky komision është një komision që shprehet kryesisht për ligjet kushtetuese dhe jo për ligjet e tjera për shumicën e vendeve.

Nga ana tjetër, duke u njohur me faktin që edhe PD-ja ka vlerësimin e saj, ka ardhur me një dokument të saj, mendoj se është shumë pozitive dhe shumë e drejtë që dokumenti i PD-së t'i bashkëngjitet dokumentit që do t'i paraqitet Komisionit të Venecias, së bashku me draft-strategjinë dhe analizën e gjetjeve, në mënyrë që t'i paraqesim komisionit një paketë të plotë.

Sigurisht, është normale të mos biem dakord për pika të veçanta. Edhe ne në grupin tonë kemi pasur gjatë diskutimeve shumë pozicione të ndryshme dhe të gjitha këto i kemi paraqitur në materialin shpjegues.

Një skenar më i vështirë është që ne të arrijmë të përgatisim një alternativë, e cila merr parasysh të gjitha avantazhet, disavantazhet, rrethanat dhe kontekset shqiptare.

Sa u takon ekspertëve që më pyetët, ju i keni emëruar shumë vonë kolegët tuaj në proces. Ata kanë punuar me dokumentin tuaj të strategjisë dhe kjo ka qenë një zgjedhje juaja. Ata nuk u emëruan në kohë, por asgjë nuk ka humbur, sepse procesi dhe diskutimi sapo ka filluar dhe ky është vetëm drafti i parë dhe ne i mirëpresim ekspertët e PD-së në diskutimin, që sapo ka nisur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje?

Eduard Halimi – Faleminderit, zoti Deville për vlerësimin dhe për qëndrimin korrekt në lidhje me ekspertët, që ishte i ndryshëm nga ai i bashkëkryetarit!

Fatmir Xhafaj – Ku ishin të ndryshëm ata apo se ky është gjerman dhe tjetri është shqiptar? I çudite të gjithë. Hallall të qoftë!

Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Megjithatë, ai është profesor dhe librat e tij i ke lexuar edhe ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Urdhëroni, zoti Ristani!

Arben Ristani – Duke vazhduar aty ku e la zotëria, që i mirëpret ekspertët e propozuar nga PD-ja, desha të di se megjithëse janë emëruar vonë, gjithsesi, ka pasur kohë të mjaftueshme (besoj se janë emëruar që para 2 muajsh). Çfarë e ka penguar që këtë draft t'ua prezantojë edhe atyre dhe të marrë edhe mendimin e tyre, në lidhje me këtë draft?

Fatmir Xhafaj – E ka bërë me ekspertët e partive të tjera që ta bëjë me ata të PD-së?

Arben Ristani – Po me PS-në, pse e ka bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ne këtu, i kemi miratuar së bashku ekspertët.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Pse të mos ua prezantojë edhe atyre programin dhe draftin? Edhe i emërojmë si ekspertë, edhe s'u marrim mendim!

Rainer Deville - Për ta përmbledhur, me sa kam kuptuar, ekspertët tuaj kanë punuar me dokumentin që keni përgatitur. Ai ishte menduar të dilte më 10 shtator dhe kam informacion që vetëm para disa ditësh është përfunduar. Keni të drejtën tuaj të përfshihen në proces, sepse procesi është i hapur dhe besoj se është shumë e drejtë që dokumenti që keni përgatitur, t'i bashkëngjitet dhe t'i paraqitet Komisionit të Venecias.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit!

Kush ka diskutime?

Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj ekspertë,

Zoti Smibert dhe zoti Deville,

Unë do të shpreh disa mendime në cilësinë e anëtarit të komisionit, duke nënvizuar së pari se me kolegët e opozitës kemi një problem, i cili është psikologjik, që do të thotë se kolegët e opozitës, ende nuk janë të bindur se reforma kushtetuese është e pakthyeshme. Ajo do të bëhet bashkërisht me ju dhe me ne.

Së dyti, ky proces nuk ka karakter shterues, e shpjegoi zoti Deville, se ai do të kalojë në disa hallka sa profesionale, ligjore, aq dhe politike, duke përfshirë këtu edhe angazhimin e Komisionit të Venecias.

Unë edhe zoti Majko kemi qenë anëtarë të Komisionit për Hartimin e Kushtetutës në vitin 1998. Partia Demokratike nuk mori pjesë në atë komision, e abandonoi, madje kërkoi edhe referendum për ta rrëzuar. Sot juve ju vjen keq pse po ndryshojnë 53 apo 58 nene të kësaj Kushtetutë. Për këtë Kushtetutë ju nuk keni lënë gjë pa thënë dhe pa bërë, ndërsa sot betoheni për këtë Kushtetutë. Kjo është pjesë e atij sugjerimi, përcaktimi apo e asaj që thashë se problemin ju e keni psikologjik, sikur këtu kushedi se çfarë po bëhet, po thuret, po bëhet në hije, po bëhet fshehurazi. Ju keni të drejtë të paraqisni mendimet tuaja, ekspertët tuaj edhe pse janë me vonesë të shqyrtojnë draftin dhe t'i bashkëngjitet draftit të ekspertëve, të shkojë te Komisioni i Venecias, por procesi nuk duhet të ndalojë. Ky është një proces i pakthyeshem dhe nëse është nevoja jo 58 nene, por e gjithë Kushtetuta të ndryshojë. Ne jemi në reformë. Ky vend ka nevojë të reformohet thellësisht edhe në këtë pjesë, në këtë strukturë themelore të shtetit.

Për sa u përket mendimeve për draftin, në radhë të parë jam plotësisht dakord me amendamentet. Ashtu siç e thanë zoti Xhafaj dhe zoti Majko, kjo është një punë e shkëlqyer, me përkushtim, e bërë për kaq muaj. Më pëlqen fakti që vetë ekspertët e huaj thonë se ky draft apo këto amendime nuk janë shteruese, sepse në rrugë e sipër mund të bëhen edhe propozime, rregullime të tjera, një pjesë të cilave unë do t'i bëj prezent. Ato lidhen ose me amendimin ose me përkthimin e dobët, si për shembull në nenin 2 thuhet: "Republika e Shqipërisë merr pjesë në Bashkimin Europian". Kjo është një terminologji e gabuar. Duhet të thuhet: "Republika e Shqipërisë është anëtare e Bashkimit Europian".

Së dyti, neni 9 parashikon termin "rezident", ky term nuk është një fjalorin e shqipes. Ka vërejtje të tilla. Unë ju bëj me dije se personalisht kam paraqitur disa komente pa ruajtur epërsinë që kam plotësisht të drejtë, por le të jetë pjesë ndihmuese edhe juaja, edhe e Komisionit të Venecias. Kam dhënë disa mendime për të ndihmuar procesin dhe jo për ta abandonuar atë.

Problem tjetër që ia vlen të diskutohet është se ky draft nuk parashikon ndryshimet kushtetuese që do të ketë drafti për dekriminalizimin apo ndryshimet që nevojiten dhe ngrihen herë pas here për organizimin e pushtetit. Por duke qenë se theksohet që ndryshimet e propozuar në këtë material nuk janë shteruese, gjykoj se strukturat e parlamentit, vetë komisioni

për ndryshimin e Kushtetutës apo vetë ekspertët vendas dhe të huaj, duhet t'i kenë parasysh të gjitha propozimet edhe për pjesën e Kushtetutës, të cilat nuk janë analizuar në draftin që kemi përpara.

Një çështje tjetër që më bën të ndalem dhe ta evidentoj është: për shembull, ka Gjykatë të Shkallës së Parë dhe Gjykatë të Lartë Administrative, po ku merr formë të prerë vendimi?

Së dyti, nuk theksohet natyra unifikuese e Gjykatës së Lartë, që është një gjë e domosdoshme. Thelbi i reformës lidhet edhe me procedurën e gjykimit me afate dhe veprime të tjera procedurale, që kryen gjykata sot. Këto janë çështje që nuk preken në draft.

Një çështje tjetër është se krahas propozimit për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve, me të cilën unë jam plotësisht dakord, duhet të theksohet edhe heqja e imunitetit të deputetëve, apo jo profesoresha e Kushtetutës? Plotësisht dakord!

Ka edhe probleme të tjera, të cilat pa u zgjatur, pasi në thelb i thashë, gjykoj se këto komentet duhet të jenë pjesë e hapësirave bashkëngjitur projektit që miratojmë dhe të biem dakord për t'ia dërguar Komisionit të Venecias. Unë i kam në dispozicion, jua vë në dispozicion juve dhe komisionit për t'i parë. Them me modesti se nuk kam ndonjë mendim se ato që them unë janë plotësisht të sakta dhe të vërteta, por shikojini me kujdes. Rëndësi ka të ecim përpara.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi - Më duhet ta them që në fillim se mbështesim plotësisht punën dhe integritetin e ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët janë përfshirë në këtë proces. Kam vlerësimin maksimal për përgatitjen, për kontributin, për impaktin, profesionalizmin dhe integritetin e të dy ekspertëve, të dy misionëve që ata përfaqësojnë në Shqipëri, personal, si edhe në emër të opozitës, veçanërisht të Partisë Demokratike.

Më duhet të them se e gjej të pamundur të pranoj faktin e mospërfshirjes në diskutimin e më përparshëm të ekspertëve të propozuar nga PD-ja. Ne e bëmë me misionet. Në momentin që ne përgatitëm draft -strategjinë sipas qëndrimit të opozitës parlamentare para se ta bënim publik rastin, ne e diskutuam paraprakisht. Mendoj se do të ishte më e udhës që ky proces të ishte zhvilluar në të njëjtin ritëm. Procesi është një proces që duhet të vlerësohet. Nga ana tjetër, e gjej, të pamundur që të them se ky produkt është, siç thuhet nga Partia Socialiste, produkt

vetëm i ekspertëve ndërkombëtarë, pra e kanë bërë vetëm ekspertët ndërkombëtarë, sepse, në fakt, të shohim mjafton të kthejmë kamerat nga krahu tjetër, apo mjafton të klikojmë edhe në komision, apo edhe të pranojmë e të dëgjojmë ato që thanë ekspertët ndërkombëtarë, rezulton se në këtë komision dy janë ekspertë ndërkombëtarë, tre të tjerët janë ekspertë vendas. Këtu, në këtë tavolinë. Po të doni hapni edhe faqen tjetër. Pra, nga 20 e ca ekspertë të nivelit të lartë, as 10% apo 15 %, nuk janë ekspertë të huaj. Ekspertët shqiptarë, të gjithë nga i pari deri tek i fundit, janë të gjithë, që kanë përfunduar studimet minimalisht para vitit '90. Fakt ky i njohur botërisht, i pa kundërshtueshëm. Për këtë arsye, unë e kam të pamundur, personalisht, që të mosbesoj se në draftin e paraqitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë të mos shoh duart, gishtërinjtë e ekspertëve vendas, të cilët përbëjnë 90%. Pse? Kam respekt profesional, mbase për shumë prej tyre, por e kam të pamundur ta pranoj që ata të na i shisnin si ekspertë, të huaj nuk na i shisni dot, por të paktën si të pavarur. E kam të pamundur ta besoj një gjë të tillë. Mundet të jenë nesër, në mënyrë të padiskutueshme, deputetë këtu, bashkë ne ne të tjerët, absolutisht, janë ulur, mund të afrohen. Në këto vite kemi parë që ulen atje në fillim, pastaj vijnë këtu, pastaj ikin prapë kryetar bashkie, absolutisht i mirëpres dhe i vlerësoj. Po e kam të pamundur ta them: shiko, këta janë të pavarur. Këta janë njëlloj. Nuk e bëj dot. Ku i shohin problemet? Pse mendoj që puna, drafti që ne kemi në dorë, nuk është një punë vetëm e dy ekspertëve ndërkombëtarë dhe e misionit OPDAT, dhe EURALIUS? Sepse e kam të pamundur sërish ta besoj, sesi në 58 nene, 10 janë për BE-në, që duhet të jetë ndonjë lapsus që i kanë futur këtu, se në BE ne nuk jemi, ose ne nuk e kemi vënë re. Po e ka vënë re Partia Socialiste. Por dakord në 58 amendamente, që i ngelen rreth 50 se 8 janë për BE-në e kam të pamundur, thashë edhe një herë, të mos shoh gishtat e ekspertëve vendas, kur shoh që krijohen 9 institucione të reja kushtetuese, në mos gaboj, të cilat krijohen me juristë, që kanë më shumë se 20 vjet eksperiencë. Pra, të gjithë këta që do të punojnë në këto institucione që do të kontrollojnë të gjithë sistemin gjyqësor; Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, prokurorët dhe gjyqtarët, prokurorin e Përgjithshëm, SPAK-n e me radhë të gjithë të tjerët, duhet të kenë eksperiencë më shumë se 20 vjet si juristë. Ku na çon kjo? Na çon te juristët që kanë mbaruar në kohën e diktaturës. Pra, tek ata, të cilët bëjnë sot të gjithë grupin e ekspertëve të nivelit super të lartë. E kam të pamundur ta konceptoj dhe e kam të papranueshme, po them edhe ndaj ndonjërit prej ekspertëve vendas që është këtu, që të heqë kushtin për t'u bërë gjyqtar nga Shkalla e Parë deri në Gjykatën e Lartë, në Shkollën e Magjistraturës. Janë bërë beteja në këto 10 - 15 vjet në këtë parlament, nga dita kur edhe unë personalisht kam qenë te

Shkolla e Magjistraturës dhe kam ikur për këtë arsye, sepse kam bërë betejë, bashkë kemi bërë betejë në këto 15 vjet, që në sistemin gjyqësor duhet të vijmë vetëm nga Shkolla e Magjistraturës; që në Gjykatën e Lartë të jenë vetëm nga brenda sistemit. E kam të pamundur, thashë, të mos shoh gishtat e ekspertëve vendas aty, kur vendoset e zeza mbi të bardhë që të bëhesh gjyqtar nuk ke nevojë nuk ka nevojë të kesh mbaruar Shkollën Magjistraturës, mjafton vetëm arsimi juridik. Nenin e kemi këtu, po të doni jua lexoj. E kanë mediet. E kam të pamundur sërish

Fatmir Xhafaj - Më mirë thuaje që të orientohen gazetarët dhe ta shikojnë. Thuaje konkretisht me nen. Nuk e gjete nenin?

Eduard Halimi - E kam këtu.

Për mediet, neni 28: “Ndryshimet në nenin 136 të Kushtetutës, pika 5: “Gjyqtarë mund të jenë vetëm shtetasit shqiptarë me arsim të lartë juridik” Pra, është hequr kushti për Shkollën e Magjistraturës. “Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative mund të jenë juristët”, pika 2, “të spikatur më shumë se 20 vjet eksperiencë”. Kush janë këta që do të jenë? Pra, më shumë se 20 vjet Vasilika. Neni 136, pika 2. Pra, për në Gjykatën e Shkallës së Parë nuk ka nevojë të jesh gjyqtar, mund të vijmë nga jashtë, dhe këtë debat e kemi bërë. Ju e mbani mend shumë mirë se ekspertët vendas kanë qenë këtu, ekspertët e huaj nuk kanë qenë. Pra, ekspertët vendas kanë qenë këtu. Në vitin 1999-2000, kjo gjë ka ndodhur në të njëjtën situatë, hoqën të gjithë gjyqtarët, nëpërmjet një provimi, dhe u lanë në pritje studentët e Shkollës së Magjistraturës, në atë kohë isha edhe unë, derisa, u mbush e gjitha me militantë. E gjitha. U morën policë dhe u çuan në Gjykatën e Tiranës. U morën juristë, që nuk kishin mbaruar Shkollën e Magjistraturës, se ishim ne brezi i parë, dhe u emëruan këta. U mbushën të gjithë, u plotësua e gjithë Gjykata e Tiranës dhe pastaj, i morën dhe i çuan studentët Magjistraturës njërin në Gramsh, njërin në Kukës, sepse nuk kishte vende, se i kishin zënë këta të tjerë. Kjo është. Kjo është thënë këtu. Dhe ku të çon kjo? Kjo të çon në kapje. E kam të vështirë që të them që jo kjo të çon në pavarësi. Kjo nuk mund të çojë në pavarësi. Ndaj unë ju përshtes dhe jam plotësisht dakord me një sërë ndërhyrjesh që janë bërë aty, për luftën pa kompromis ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Përshtes, në mënyrë të padiskutueshme, ekspertët ndërkombëtarë, me të cilët kam folur gjatë këtyre javëve, gjatë këtyre muajve. Ua kemi bërë të qartë që ne përshtesim krijimin e SPAK-ut, është e vërtetë, jua kemi çuar me shkresë edhe me strategji të Byrosë së Hetimit, jo nga qeveria, por nga prokuroria, e përshtesim qëndrimin e

ekspertëve. Por ama, mekanizmi i kontrollit të ndërtimit të të gjitha institucioneve të çon në një proces të dyshuar për kapje, sepse e kam të vështirë ta mendoj dhe ta pranoj që prokurorët do të jenë të pavarur, ku sipas, neneve 40,45,49,51 dhe 57, rezulton se ministri i Drejtësisë mund të kontrollojë punën e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Por Inspektorati i Lartë i Drejtësisë kontrollon prokurorët dhe gjyqtarët, atëherë sigurisht që e ka nën kontroll. Nëse unë kam nën kontroll, inspektoj kontrollonin kam nën kontroll edhe atë tjetrin, apo jo? E kam përsëri të vështirë ta pranoj që në të gjithë ndryshimin e skemave që krijohen: të ndryshimit, të ndërprerjes së mandateve të anëtarëve të KLD-së si dhe ndryshimin dhe emërimin tyre, pikërisht nga kjo kastë e juristëve dhe e gjyqtarëve që kanë më tepër se 20 vjet, sepse kjo më çon vetëm në një drejtim, në drejtimin e mbylljes së derës për magistratët në Shkallën e Parë në gjyqësor, për prokurorinë e përshëndes, sepse për prokurorinë e kanë pranuar në Kushtetutë që thonë: jo, prokuror mund të bëhen vetëm nga Shkolla e Magjistraturës, për gjyqtarët jo, e kanë lënë me qëllim. Pra, u mbyllin derën magistratëve dhe ua hapin derën gjyqtarëve që vijnë nga jashtë sistemit. Kjo ka të bëjë pikërisht edhe me debatin që kemi edhe gjatë kësaj kohe, duke hequr filtrat. Kush e pengon sot kalimin në Gjykatën e Lartë të atyre kandidatëve, të cilët nuk vijnë nga sistemi gjyqësor? Presidenti. Ju e dini ka edhe emra për këtë gjë. Atëherë, çfarë të bëjmë? T'ia heqim filtrin Presidentit, sepse na pengon Presidenti, në mënyrë që ta kemi mundësinë, që këta persona, të cilët nuk janë pjesë e sistemit gjyqësor, pra vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor, duhet të shkojnë në Gjykatën e Lartë. Ne jemi të vendosur për këtë gjë, e kemi bërë këtë gjë kur kemi qenë në qeveri. Këtu kemi diskutuar në këtë sallë dhe kemi thënë: jo, nga jashtë sistemit. Tani, këtu hiqet fare në Kushtetutë. Mund të vijnë nga jashtë sistemit dhe, kur vijnë nga jashtë sistemit, përsëri e kam të pamundur ta besoj që këtu nuk janë gishtërinjtë e ekspertëve vendas e shumë gjëra të tjera, që nuk dua të zgjatem.

Por në përfundim të fjalës sime, unë mbështes tërësisht edhe konkluzionin e thënë këtu nga shefi i misionit EURALIUS, edhe nga shefi i misionit OPDAT, ky është një draft paraprak. Për ne një pjesë e mirë është nga ekspertiza ndërkombëtare, ne jemi skeptikë për këto arsye që thashë, që janë edhe gishtërinjtë e ekspertëve vendas, të cilët, për mendimin tim, duhet të përjashtohen nga promovimi, se janë në konflikt interesi. Në qoftë se bëjmë ligje që i bëjmë për veten tonë, sigurisht që duhet të përjashtohen për 5 vjet. Por këto janë gjëra që duhet t'i shohim kur të bëjmë ligje të tjera.

Unë gjykoj që ky draft që ka ardhur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, dy ndërkombëtarë dhe tre shqiptarë, që janë këtu, të shkojë në Komisionin e Venecias, sepse e kemi kërkuar këtë gjë. Absolutisht. Zoti Braho i ka përgatitur propozimet e veta dhe unë e gjej të udhës që edhe ato propozime duhet të shkojnë që Komisioni i Venecias të shohë mendimet e zotit Braho. Edhe opozitës t'i jepet kohë, nuk kemi pasur mundësi për dy ditë, sepse janë 53 amendamente. Ne kemi këndvështrim tjetër, zoti Braho ka të vetin. Ne kemi probleme lidhur me draftin dhe këto shqetësime që kemi ne t'ia parashtrijmë Komisionit të Venecias, siç tha zoti Majko. Ka një problem tek ato që thotë, ndoshta një keqkuptim në atë që thotë zoti Majko, për të sqaruar. Ne kemi përgatitur draftstrategjinë, siç e kemi përgatitur edhe ju draftstrategjinë dhe jemi dakordësuar, në fakt, me partnerët ndërkombëtarë dhe ata kanë pyetur Komisionin e Venecias, të cilët i kanë thënë se ne nuk do të shqyrtojmë draftstrategjinë, pra 400 faqet tuaja dhe 200 faqet tona, por do të shqyrtojmë draftet. Ne jemi dakordësuar për këtë gjë, për hir të së vërtetës. Kemi thënë po, dakord. Për draftin ne duhet të japim komente. Këto komente duhet t'i shohë Komisioni i Venecias. Ne kërkuam një javë kohë që të përgatisim këto komente.

Por për të hequr çdo lloj dyshimi, se këtu është çështje besimi dhe sinqeriteti, mbi të gjitha, që ne të mos kemi asnjë lloj shqetësimi me njëri-tjetrin në besimin e ndërsjellë, të përcaktohet që sot, të merret vendimi që sot, po, ky draft, kështu siç është edhe me kritikën, nuk ka problem, t'i shkojë Komisionit të Venecias, t'i nisët ditën e hënë në datën 5, ora 12:00 bashkë me komentet e paraqitura. Pra, Partia Demokratike me ekspertët do të paraqesë komente, do të shkojë me një dosje dhe do shikohen komentet tona, komentet e çdo force tjetër politike. Kjo është krejt logjike. Pse? Se është draft fillestar, me të drejtë, siç tha zoti Deville dhe përfaqësuesi i OPDAT-it, Jon. Nuk është çështja që ne do të vendosim nesër për t'i miratuar. Të marrim edhe vlerësimin e Komisionit të Venecias dhe pastaj të vazhdojmë procesin normalisht. Ky ishte propozimi që bëra në fillim.

Më duhet ta mbyll përsëri me një propozim të tillë në mënyrë që të kemi një produkt konsensual, nëse do të arrihet, dhe pastaj t'i kalojmë në votim siç u shpreh zoti Majko.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Deville gjatë kohës që ju flisnit kërkoi të ndërhynte për të bërë disa sqarime.

Rainer Deville – Dua të shpreh kënaqësinë time për shtatë komentet që u bënë lidhur me përmbajtjen e draftpropozimeve.

Në radhë të parë, duhet të kemi parasysh që këto ndryshime kushtetuese marrin parasysh kërkesat për të përmbushur standardet për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Ndërkohë që shumë nga këto propozime dhe këto dispozita, nëse do të miratohen, mund të mos kenë një efekt të menjëhershëm. Në dispozitat transitorë mund të parashikohet që ato do të hyjnë në fuqi në momentin e anëtarësimit që do të ndodhë pas disa vitesh. Nga njëra anë ne shfrytëzojmë momentin politik për anëtarësimin në BE dhe nga ana tjetër shmangim nevojën për të bërë një ndërhyrje të dytë për të ndryshuar Kushtetutën.

Sigurisht, ashtu siç e përmendët, ky është një propozim për ta hequr totalisht imunitetin e gjyqtarëve dhe për të siguruar për ta mbrojtjen standarde të të drejtave si për të gjithë qytetarët shqiptarë. Imuniteti që ka ekzistuar deri tani ka qenë në kundërshtim me opinionin e Komisionit të Venecias.

Për sa i takon kriterit për Shkollën e Magjistraturës, për gjyqtarët, nuk është e vërtetë që është hequr si kriter, por ne kemi menduar që procedura dhe kushtet për përzgjedhjen e gjyqtarëve të parashikohen në nivel ligjor dhe jo kushtetues. Ky kriter specifik për Shkollën e Magjistraturës të parashikohet në nivel kushtetues nuk shoh ndonjë problem lidhur me këtë.

Sa i takon kriterit për përvojën 20-vjeçare, në fakt, ne e kemi reduktuar kriterin prej 20 vjetësh përvojë në 15 vjet në shumicën e dispozitave të propozuara, por nuk e kemi hequr për sa i takon inspektoratit, sepse ata anëtarë të inspektoratit duhet të kenë një përvojë të mjaftueshme për të inspektuar kolegët e tyre.

Ka qenë një pikë diskutimi për sa i takon edhe dispozitave të tjera nëse do të duhet të lejojnë përvojën vetëm me 15 vjet dhe në qoftë se ju mendoni që kjo është më e përshtatshme, ne nuk shohim ndonjë problem lidhur me këtë.

Për sa u takon inspektorëve, sigurisht mekanizmi për të inspektuar vetë inspektorët duhet të bëhet nga një palë tjetër. Nuk mundën inspektorët të inspektojnë veten e tyre.

Duhet të kemi parasysh që si në nenin 49 edhe në nenin 147/f vendimin nuk e merr ministri por e merr tribunali disiplinor. Pra, argumenti që këtu kemi një kapje nuk qëndron pasi vendimi merret nga tribunali disiplinor e jo nga ministri.

Fatmir Xhafaj – A ka diskutime të tjera?

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Sigurisht që reforma në drejtësi është e mirëpritur nga të gjithë. Të gjithë e dimë që sot vendi ka nevojë për një reformë.

Në mënyrë që reforma të jetë e qëndrueshme e të mos jetë vetëm gjatë kohëzgjatjes së një pushteti, por t'u shërbejë më gjatë nevojave të vendit, menduam dhe kërkuam që në fillim që edhe opozita të ishte pjesë në mënyrë që edhe ajo të kontribuonte për të pasur një reformë solide.

Po kështu ramë dakord që t'i drejtoheshim ekspertizës ndërkombëtare në mënyrë që të arrinim në një nivel më të lartë të cilësisë së reformës.

Duke qenë se bëhet fjalë për sistemin e drejtësisë, duhet të ecnim edhe mbi bazën e disa shtyllave kryesore që janë parime themelore në sistem, siç janë pavarësia e sistemit, vetëkontrolli i sistemit.

Nga një lexim i ndryshimeve që po na paraqiten, unë kam përshtypjen që të paktën këto dy parime shkelen rëndë; parimi i pavarësisë dhe i vetëkontrollit të sistemit. Këtu do të hap një parantezë, sepse ndërkohë bëhet fjalë për mbi 50 ndryshime kushtetuese, bëhet fjalë për rreth 9 institucione të reja kushtetuese që krijohen, bëhet fjalë për ndërprerjen e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të prokurorit të Përgjithshëm. Pra, bëhet fjalë për gjëra shumë të rëndësishme të kësaj reforme.

Unë, duke shfrytëzuar bagazhin tim juridik dhe përvojën që kam, u mundova shumë gjatë gjithë ditës së shtunë dhe të diel ta asimiloj këtë punë të bërë nga shumë ekspertë për mbi 8 muaj. Pra, për më shumë se 8 muaj kanë punuar për këtë dhe unë ditën e shtunë dhe të diel u përpoqa shumë ta asimiloj. Më vjen mirë që dhe zoti Braho ka punuar dhe ai si unë ditën e diel. Për shembull bëri vërejtje të rëndësishme, për sa i përket fjalës rezident, nëse duhet të ishte apo jo. Duhej thënë jo merr pjesë, por është anëtare. Domethënë janë vërejtje me themel, që gjatë shqyrtimit të materialit të shtunën dhe të dielën ka arritur t'i kapë këto elemente shumë kryesore.

Çështja është që për një gjë kaq të rëndësishme pse të mos kemi një të hënë dhe një të martë, por vetëm të shtunë dhe të diel për të asimiluar punën 8-mujore të shumë ekspertëve. Do të ndryshojmë Kushtetutën, mbi 50 nene, 9 institucione të reja, ndërprerjen e mandatit të prokurorit të Përgjithshëm, të anëtarëve të KLD-së. Dhe opozita ka vetëm të shtunën dhe të dielën që ta shqyrtojë këtë çështje. Për më tepër pastaj dhe gjetje të tilla si të përcaktosh rrogën me Kushtetutë. Është vërtet një punë shumë e mirë e ekspertëve. Dhe rrogën ta përcaktojnë në Kushtetutë, vetëm rrogën e ekspertëve, të atyre që nesër do të bëhen komisionerë. Domethënë punojnë si ekspertë sot, e përcaktojnë rrogën e tyre në Kushtetutë që ta kenë nesër kur të bëhen komisionerë. Komisioni i vlerësimit e ka të përcaktuar, e vënë dhe rrogën në Kushtetutë.

Ajo që është më se e qartë, kërkojmë patjetër, pak më shumë kohë brenda një normaliteti të zakonshëm në mënyrë që të shqyrtojmë këtë material, i cili siç u bë e qartë, nuk i ka kaluar asnjërit nga ekspertëve që opozita kishte caktuar. Por tek e fundit gjithsesi ekspertët janë ndihmësit tanë, ne do të votojmë. Dhe unë që të votoj më duhet patjetër pak më shumë kohë që ta shqyrtoj këtë material, në mënyrë që të paktën të jem i qetë që e thashë fjalën time kundër kapjes së pushtetit gjyqësor, kundër një gjyqësori që i përket një partie. Por, për ta detajuar këtë, më duhet patjetër sa më shumë kohë.

Fatmir Xhafaj – Ka kolegë të tjerë për të folur?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë e mora për herë të dytë fjalën për të nënvizuar një fakt për të cilin me thënë të drejtën kisha dyshim që kur filloi ky diskutim. Dhe sot me plot gojën, duke falënderuar dhe kolegët e opozitës, pa dashur të krijoj asnjë insinuatë, mendoj se për herë të parë mund të themi që kemi një proces të plotë zyrtar të nisjes së diskutimit për ndryshimin e Kushtetutës. Më lejoni që në këtë rast të falënderoj në mënyrë të veçantë ekspertët shqiptarë dhe ekspertët e huaj. Do ta citoj zotin Ristani që ekspertët në fund fare janë ndihmësit tanë. Ne mund të jemi politikanë të mirë, por ekspertë mund të jenë disa, jo të gjithë, aq më tepër 140 deputetë në Kuvendin e Shqipërisë.

Fakti që ne sot ramë dakord t'i konceptojmë të gjitha këto propozime jo të shkruara në shkëmb, por të shkruara në letër, fakti që ne ramë dakord që t'i drejtohem bashku me të gjitha llojet e rezervave, me pozitivizmat dhe negativizmat për këtë proces Komisionit të Venecias, mendoj se në thelbin e vet e bën procesin të plotë, zyrtar të nisur, dhe mendoj se ne shkojmë me një justifikim shumë të qartë përballë parlamentit duke i propozuar që procesi, veprimtaria e komisionit të posaçëm të shtyhet deri në datën 30 qershor 2016, pasi tanimë falë dhe punës së ekspertëve, dokumenteve, diskutimeve, debateve shpesh me vështirësi, diku dhe me një lloj ngërçi, por sot e përsëris ne kemi një proces të plotë, të përbashkët, i cili nga ana procedurale mund ta konsideroj të nisur si të tillë.

Prandaj, në radhë të parë, e mora fjalën për të vlerësuar punën e ekspertizës shqiptare dhe ndërkombëtare duke nënvizuar që dhe vlera e shtuar e ekspertëve që i kaluam sot Presidentit të Republikës, të ekspertizës që miratuam në muajin korrik të Partisë Demokratike, do ta bëjnë më të plotë, më të kualifikuar të gjithë këtë proces, ashtu siç thashë dhe pak më parë, një hartë e cila do të na e bëjë të qartë se ku jemi dakord dhe ku nuk jemi dakord. Të mendosh që tani me

draftin e parë ne do të binim dakord në mes të kësaj sherrnaje aktualisht për arsye të tjera politike, do të binim dakord për të ndryshuar Kushtetutën me një draft fillestar, ky do të ishte minimalisht naivitet fëminor. Prandaj mendoj se pavarësisht nga kjo sherrnajë që na rrethon, ky diskutim i sotëm, unë mendoj se i tejkaloi dhe parashikimet më optimiste dhe ne sot kemi një proces të nisur.

Dhe një herë më lejoni të falënderoj kolegët e opozitës, në mënyrë të veçantë grupin e ekspertëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri - Faleminderit!

I bashkohem dhe unë vlerësimit të kolegëve mbi punën e ekspertëve, veçanërisht ekspertëve të huaj. Siç e do rasti, ca me sinqeritet, ca më pak të sinqertë, për kolegët e kam fjalën, ca më optimistë, ca më pak optimistë, mirëkuptimin tim e keni të plotë dhe me sinqeritet, për shkak se çështja mbi të cilin jeni thirrur të jepni detajet dhe të na ndriçoni teknikisht, në fakt është e komplikuar, sherrnajë, nuk e di në do e përktheni dot anglisht, por më duhet të citoj kolegun Majko. Unë thashë një sherrnajë. Është e vërtetë që është një sherrnajë. Në themel nuk është një sherrnajë politike, nuk është një grindje. Kjo buron nga fakti që ky popull në 46 vjet ia ka parë sherrin sistemit të drejtësisë që jepte padrejtësi. Dhe këtë e bënte bazuar në një Kushtetutë, hartuesi i së cilës është kreu i grupit të ekspertëve vendas. E bënte duke përdorur prokurorët, gjyqtarët dhe hetuesit, të cilët me ligj dhe me Kushtetutë ishin të detyruar të zbatonin vendimet e partisë-shtet. Domethënë këta janë shkaktarët e sherrnajës dhe të dëmit. Ky është dëm financiar, që ky shtet po e paguan akoma sot ndaj qytetarëve të tij. Do të më duhet të përmend faktin, duke pasur parasysh vështirësinë e punës tuaj, që nga 15 ekspertë vendas, 9 prej tyre i keni me eksperiencë pune, 2 prokurorë, 3 hetues, 3 gjyqtarë të kohës së komunizmit.

Të nderuar zotërinj ekspertë,

Na keni sjellë këtu për mosbesimin tim dhe më vjen keq që duhet ta them, se dua të jem deri në fund i sinqertë, nuk gjej dot një shembull amerikan për këtë punë, por një shembull gjerman e gjej.

Na keni sjellë këtu një draft me të gjitha gjërat e panevojshme dhe nga teknika legislative me të cilat u shpreh zoti Ristani, në bashkëpunim praktikisht me Roland Fraisler. Ai

ka një homolog në Shqipëri, ka shumë, janë aktivë. Fenomeni Roland Fraisler është anëtar i grupit të ekspertëve në masën mbi 60%. Ky është problemi që unë kam me draftin, ky është mosbesimi që unë kam me draftin, ky është shkaku që sherrnaja vazhdon. Prandaj mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme që nën këtë eksperiencë të Roland Fraisler, që gjermanët e kanë pasur vetëm 13 vjet, shqiptarët 46 vjet. Ndoshta...

Ndoshta do të ishte mirë të kishte më shumë transparencë, pak më shumë kohë për t'u menduar, përpara se të prekim pesëdhjetë e ca herë Kushtetutën, të krijojmë dhjetë apo nëntë institucione të tjera, duke lënë gjithçka në varësi të Kryeministrit, të ekzekutivit praktikisht. Ndoshta do të ishte mirë, nuk do të ishte e tepërt, që edhe pjesa tjetër, ajo që ka qenë gjithmonë përballë Roland Fajslërit, të kishte mendimin e tij. Ndoshta do të ishte një kontribut për një drejtësi të drejtë dhe jo diçka të përafërt. Mendoj se është një moment për të reflektuar pa naivitet, por duke u thelluar mbi gjënë. Ndoshta jemi në momentin e fundit për ta bërë këtë reformë të të gjithë shqiptarëve, jo vetëm të Roland Fajslërit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndoshta e kam kuptuar gabim rendin e ditës, por në rendin e ditës kanë qenë ose janë tre çështje, të cilat unë i vlerësoj si çështje teknike, dhe besoj se nuk është kjo mbledhje ajo që do të vendosë për variantin final të ndryshimit të Kushtetutës.

Ne kemi një përvojë – unë dhe zoti Strazimiri, por edhe kolegë të tjerë – në komisionin e dekriminalizimit, që para se të fillonim të diskutonim për projektligjet, qoftë të depozituara nga opozita, edhe nga ato që ka sjellë qeveria, iu adresuam Komisionit të Venecias. Kjo praktikë nuk është vetëm në Kuvendin e Shqipërisë, por më lejoni t'ju sjell në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese, kur është diskutuar ligji i lustracionit, një nismë atëherë, Gjykata Kushtetuese ndërpreu shqyrtimin dhe nuk dha asnjë opinion, duke kërkuar një mendim miqësor nga Komisioni i Venecias.

E dyta që do të doja të theksoja, është se ne po keqinformojmë qytetarët, por edhe të gjithë ekspertët këtu. Madje, po i vëmë ata në pozitë të vështirë, duke thënë që ju keni ekspertët tuaj; ekspertët tuaj nuk ju kanë konsultuar juve, ndërsa ne, kolegët e maxhorancës kemi ekspertët tanë. Në fakt, si ju, ashtu edhe ne, nuk kemi ekspertë në grupin e ekspertëve të nivelit të lartë. në

fakt, faji është deri diku juaji, që nuk e keni kuptuar këtë përmbajtje, sepse keni hyrë me vonesë në këtë proces.

Pa dashur të bëj avokatin e tyre mbrojtës, këta janë persona që i kanë sjellë institucionet kushtetuese, por njëkohësisht i ka sjellë edhe universiteti, Fakulteti i Drejtësisë. Por këta nuk janë të vetmit, sepse po të hyni e të shikoni faqen e reformës në drejtësi, numrin e ekspertëve dhe CV-të e tyre, janë shumë.

Pra, nuk janë vetëm 10% e ekspertëve të huaj dhe pjesa tjetër janë shqiptarë, sepse pas kamerave unë shoh edhe shumë miq e kolegë të huaj, të cilët kanë punuar për të bërë reformën për arsimin e lartë, për të bërë reforma të tjera në profesione të rregulluara, për të bërë reforma të tjera në fushën e prokurorisë e gjykatës.

Ju dhe unë bashkë, kemi bërthamën e atyre që kanë punuar për reformën në Kushtetutë apo për t'u hapur rrugë ndryshimeve kushtetuese. Nga ana tjetër, do të doja të theksoja edhe një herë faktin se nuk është mirë të etiketojmë e të vlerësojmë vetëm ekspertët e huaj. Unë do t'i vlerësoja e do t'i falënderoja ekspertët ndërkombëtarë, sepse ata kanë marrë përsipër të bëjnë atë gjë që ne nuk e kemi bërë. Sepse, po të ishim ne, klasa politike, të aftë dhe të kishim vullnet jashtë kësaj retorike që ta bënim këtë reformë, nuk do të kishim nevojë të punonin kaq shumë, me kaq përkushtim, qoftë zoti Jon, qoftë zoti Rainer. Si dhe shumë ekspertë të tjerë të OSBE-së, Fondacionit "Soros", ekspertë të tjerë, të cilët aktualisht nuk janë të pranishëm në tavolinën ku jemi ulur ne.

Nga ana tjetër, ne duhet të heshtim. Më falni që e them. Unë nuk kam qenë pjesë e ndryshimeve kushtetuese në 2008-ën, por në qoftë se ne kemi një faj, është pikërisht ai disbalancim që kemi shkaktuar falë ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, të cilat na kanë sjellë këto probleme ose këto rrjedhoja në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Në këtë fundjavë, unë i kam lexuar, sikurse edhe ju, mendimet ose propozimet që sillen për të ndryshuar Kushtetutën. Pra, as unë, as zoti Pandi, absolutisht nuk i kemi pasur më përpara, sepse nuk është produkti ynë. Po të donim e kishim bërë vetë. S'ishim të zotë ta bënim, ia deleguam ekspertëve të pavarur. Ata janë ekspertë të pavarur, u kemi besuar këtë detyrë, por absolutisht nuk kemi të drejtë t'i fyejmë.

Unë personalisht, vlerësoj një sërë ndryshimesh shumë të rëndësishme që bëhen këtu. Pra nuk do të kemi gjyqtarë e prokurorë që zgjidhen me 36 vota, me votat tona të parlamentit, sepse janë futur disa lloj votimesh. Absolutisht që kjo është një risi. Unë do të doja, të paktën ne

– meqenëse këtu ka media dhe mund të ketë interes – të shikonim disa elementë të rinj që sillen në ndryshimet kushtetuese. Për shembull, gjykata, prokurori i veçantë special antikorrupsion, gjykata speciale antikorrupsion, qoftë e shkallës së parë, qoftë e apelit, që është risi për mua po e po, por edhe për ju besoj. Kurrsesi nuk do të doja që në këtë diskutim të harxhonim kaq shumë kohë, qoftë me procedurat, apo të etiketonim se kush është një koleg apo një koleg tjetër.

Unë kam një shqetësim – dhe të më falin kolegët e opozitës – nuk dua të përmend emra, që të mos shkaktoj më pas replikë, por një pjesë e mirë e anëtarëve të këtij komisioni, edhe e parlamentit, edhe e juristëve që punojnë sot në Gjykatën e Lartë e në Gjykatën Kushtetuese, janë produkt i këtyre profesorëve shqiptarë që janë këtu.

Në qoftë se këta janë të vjetër nga mentaliteti – të më falni një mijë herë – i bie që edhe ata gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, në Prokurori, në Prokurori të Përgjithshme, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, pra të gjithë të jenë produkt i tyre.

Atëherë, çfarë lloj diskutimi është ky? Pse arrijmë në këtë lloj trajtimi të problematikës dhe nuk vlerësojmë që të paktën këta ekspertë, këta profesorë, që i kanë sjellë institucionet – pra, nuk i keni sjellë as ju e as ne – na kanë sjellë një material, na kanë bërë gati punën, që është detyra jonë ta bënim? Të presim mendimin e Komisionit të Venecias. Më pas, besoj, në këto komisione do të kemi diskutime, duke pasur parasysh edhe rekomandimet që do të sjellë Komisioni i Venecias.

Unë, zoti kryetar, do të doja t'i falënderoja të gjithë ekspertët, pa përjashtim, por edhe të gjithë ekspertët e tjerë që nuk janë ulur sot në tavolinë, po ashtu edhe të gjithë ata që juve ju kanë dhënë mendime e opinione gjatë diskutimit e debatit.

Kam vetëm një merak, një shqetësim. Ndoshta mund të jetë problem i përkthimit. Meqenëse këtu ka disa institute të reja, sidomos në pjesën e dispozitave kalimtare, mua më duket sikur nuk është shqip. Unë e kuptoj se ky material është produkt i ekspertëve të huaj. Këtë lloj përvoje nuk e ka Shqipëria, nuk e kemi ne. Prandaj, është mirë që – në variantin anglisht, besoj se do të jetë perfekt. Duhet të jetë një përkthim nga anglishtja në shqip, sepse në variantin shqip ka nevojë për një redaktim, për të qenë më të qartë.

Sugjerimi im i dytë, zoti kryetar, është që, në kuadër të sensibilizimit edhe të procesit shumë të mirë që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka bërë për një gjithëpërfshirje, pë konsultimin publik, pë rinformimin e publikut, falë edhe medias që e ka ndjekur me shumë vëmendje këtë proces, këto ndryshime të nisen në Komisionin e Venecias, për të fituar kohë,

sepse Komisioni i Venecias ka një procedurë. Ndërkohë, të publikohen, për të pasur edhe një informim të qytetarëve, të publikut, si dhe të atyre që ndoshta u ka shpëtuar.

Ndërkaq, edhe ne do të kemi kohë për t'i studiuar. Më pas do t'i kuptojmë shumë mirë ato rekomandime e sugjerime që do të bëjë Komisioni i Venecias në lidhje me këtë draft.

Unë ju falënderoj edhe një herë, të nderuar kolegë. Ndjesë që ju drejtova dhe ju personalizova, por isha e detyruar të shpërndaja këtë tymnajë që krijohet këtu në vlerësimin e ekspertëve, për të thënë se Shkolla e Magjistraturës ka vlerë, përvoja ka vlerë, por jo gjithmonë një student që ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës është perfekt, ndërsa një që nuk e ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës nuk është perfekt.

(Diskutim pa mikrofon)

Sepse, ne kemi në komision njerëz që kanë mbi njëzet vjet, ke kolegun përbri, dhe në mënyrë indirekte e fyeve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Sapo ta ktheu përgjigjen ai. E ke gabim, tha ai zotëria atje.

Në rregull.

Zoti Manja.

Ju lutem, se do të flasë kolegu, siç folët ju, disa herë bile.

Ulsi Manja – Ju lutem, më mirëkuptoni, se dua t'i them pesë fjalë edhe unë. Jo për forcë zakoni, por si një shqetësim që besoj se e ndan çdo shqiptar me ne, si një shqetësim që buron nga brenda.

Dua të jem i qartë që në fillim: reforma në sistemin e drejtësisë do të bëhet sespe është nevojë imperative e popullit shqiptar, e shqiptarëve.

Tani unë gjej rastin të falënderoj miqtë, ekspertët e huaj dhe vendës. Ekspertëve vendës, shumicën dërrmuese të të cilëve kam pasur fatin t'i kem pedagogët e mi, u them dy fjalë: mos u merakosni, se nuk është faji juaj pse keni lindur para zotit Halimi, që keni qenë pedagogë e profesorë të zotit Halimi, sepse ai e ka problemin me Zotin dhe jo me ju.

Tani unë kam strikt rendin e ditës, dhe duke iu referuar rendit të ditës, në pikën 3, është zgjatja e mandatit të Komisionit të Posaçëm deri më 30 qershor 2016.

Këtu, një thirrje shumë miqësore e kam për ekspertët ndërkombëtarë, por edhe për miqtë e partnerët ndërkombëtarë, të cilët asistojnë reformën në sistemin e drejtësisë: ju lutem, mos u dekurajoni nga diskutimet tona, sepse shqiptarët dijnë ta ndajnë të mirën nga e keqja. Ju

ka ardhur litari në fyt nga ky sistem drejtësie. Nëse do ta lini në dorën tonë, me këtë nivel diskutimi, jo me 30 qershor 2016, por as me 30 qershor 2036 nuk bëhet reforma në drejtësi.

Lidhur me opinionin e Komisionit të Venecias, për të qenë konsekuent me atë që kam deklaruar në mbledhjen e parafundit të këtij komisioni, kur është miratuar grupi i ekspertëve të sjellë nga opozita, nisur nga vendimi i Kuvendit për ngritjen e këtij komisioni dhe metodologjia e ndjekur për reformën në sistemin e drejtësisë, do të votoj çdo draft vetëm nëpërmjet këtij komisioni dhe opinionit të Komisionit të Venecias. Çdo vlerë e ekspertëve, qoftë e opozitës, qoftë edhe e jona si maxhorancë, do të jetë vlerë e shtuar për këtë komision, sepse në një komision tjetër që ka ngritur po ky Kuvend, që është ai i dekriminalizimit, nga kolegët e opozitës që janë maxhorancë në atë komision, na thuhet që opinionin e Komisionit të Venecias do të jetë udhërrëfyesi ynë në hartimin e ligjit për dekriminalizimin dhe për ndryshimet kushtetuese, *mot a mot* ajo që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë kërkon sot nga ky komision i nderuar, që sigurisht nuk është, siç u tha nga shumica e kolegëve, diskutim shterues.

Dy fjalë lidhur me përmbajtjen, sepse diskutimin do ta rezervoj edhe kur të vijë opinionin e Komisionit të Venecias. Të shtunën dhe të dielën e kam studiuar mirë këtë draft, sepse më lidh edhe profesioni me këtë punë, si shumicën e kolegëve. Ajo që ka sot nevojë sistemi i drejtësisë dhe që e kërkojnë edhe shqiptarët, në këtë draft del qartësisht. Shmang në maksimum elementët korruptivë në sistem, rrit llogaridhënien e sistemit të drejtësisë në shkallën maksimale, siguron eficiencë, transparencë dhe rrit pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Si juristë, mund të ndajmë koncepte të ndryshme për pavarësinë e sistemit: ajo lidhet me një sërë faktorësh, por kryesisht me mënyrën e përzgjedhjes, emërimit, por edhe të buxhetimit. Një pikë e rëndësishme e këtij drafti që propozohet, është që buxheti gjyqësor i hiqet ekzekutivit dhe i kalon Këshillit të Lartë Gjyqësor. Që të jesh i pavarur, ka shumë faktorë, por një nga më të rëndësishmit është buxheti i sistemit gjyqësor.

Gjithsesi, ju falënderoj për punën e deritanishme, keni bërë atë që duhej ta kishin bërë ne për shumë vite me radhë. Çështjet e tjera, për të cilat lihet hapësirë për t'u bërë me ligje të veçanta, do të jetë karriera 20 vjet, shtatë apo tetë, këto janë çështje për të cilat do të diskutojmë.

Në finale, edhe nëse nuk arrihen të bëhen ato votat e shumë dëshiruara që parashikon Kushtetuta për ndryshim, shqiptarët aty janë, nëse nuk e bëjmë ne me kartonë, le të shprehen nëse janë të kënaqur nga ky sistem drejtësie dhe nëse e duan apo jo këtë reformë. Por ama të flasim në emër të drejtësisë: njerëz që edhe për shkak të shkollimit pas viteve '90-të, u është

dhënë mundësia të vendosin një tullë në piramidën më të lartë të shtetit, në binanë e famshme që quhet drejtësi, por nga ana tjetër ia kanë nxjerrë edhe gurët e themelit, madje kanë marrë edhe karriget kur kanë ikur nga zyra - këtu dua të jem krejtësisht me opinionin tim personal - nuk kanë të drejtën të flasin në emër të drejtësisë dhe aq më tepër t'u tregojnë shqiptarëve se çfarë është drejtësia.

Miq të mi, unë i përkas një brezi që jam shkolluar në vitet 1992-1996, në kulmin e aspiratave të shqiptarëve për t'u bërë demokraci dhe pjesë e Europës. Nuk ka rëndësi, në bindjen time më absolute, se ku ke studiuar, por qëllimi i mirë për t'i bërë gjërat siç duhet. Ne këtu, si dhe gazetarët, përtej e dimë shumë mirë kalvarin e mundimeve që kemi hasur në dyert e këtij sistemi drejtësie që kemi sot.

Ndaj, zoti kryetar, edhe sikur të kesh në dispozicion të gjithë të hënat dhe të martat e këtij viti, jam i bindur se vetëm sa do të vonohet procesi i vajtjes së këtij drafti në Venecia, pasi nuk do të ketë asnjë vlerë, sepse shihet se paragjykimi është shumë i madh. Nëse ne në këtë tavolinë, juristë, nuk vendosim një pakt mirëbesimi ndaj njëri-tjetrit, që kjo reformë duhet bërë, argumentet për të hëna dhe të marta janë thjesht shkopinj në rrota, që ne opozitë dhe maxhorancë jemi të “detyruar” t'ua japim shqiptarëve, sepse nuk presin më.

Kam thënë atë që realisht ndiej.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Folët një herë.

Eduard Halimi – Do të flas prapë.

Fatmir Xhafaj – Do të rrimë këtu e të të dëgjojmë ty? Nuk është serioze.

Eduard Halimi – Do të flas vetëm një minutë.

Fatmir Xhafaj – Dil e jep një konferencë për shtyp.

Eduard Halimi – Do ta jap edhe atë.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, atëherë. Zoti Halimi, ju lutem!

Eduard Halimi – Nuk do t'i shtoj shumë gjëra fjalimit shumë historik, që dëgjuam përpara, por dua të bëj një sqarim, jo për kolegun, por për publikun dhe ekspertët vendas.

I njoh ekspertët vendas. I kam pasur pedagogë. Siç kam pasur edhe Vasilikën. Kam respekt të madh për Vasilikën. E kam treguar. Kam edhe për Ulsiun. Nuk kam problem me Ulsiun.

Kam vlerësim për pedagogët. U flas edhe rrugës.

Fatmir Xhafaj – Ky është problemi: t’i flasim apo të mos i flasim njëri-tjetrit?

Eduard Halimi – Fatmiri, siç ka ulur Vasilikën, t’i ulë këtu. Të spostohemi disa karrige.

Të jenë deputetë të PS-së. Edhe Ulsiu ka qenë prokuror dhe është bërë deputet. E respektoj, në mënyrë të padiskutueshme. Por për mua është e papranueshme të them se Vasilika është e pavarur.

Nuk e them dot, Vasilika. E kam të pamundur, nëse bëhesh nesër gjyqtare. Ose Ulsiu të bëhet prapë prokuror.

Nuk e kam problemin për performancën personale, akademike e gjithë pjesën tjetër, por e kam të pamundur të ma shisni produktin se këta janë të pavarur. Prandaj, thashë: vlerësim maksimal për ta, për Ulsiun, Vasilikën dhe zotërinjtë që do të ulen këtu, për politikë, dhe nga krahu tjetër, si vlerë... Edhe mund të ulen. Absolutisht! I ftoj, edhe këtej mund të ulen, në mënyrë të padiskutueshme! Por kur them John Smimbert dhe Deville, kam parasysh njerëz, të cilët nuk kanë të bëjnë me politikën. Janë njerëz, të cilët janë prokurorë, gjyqtarë të Apelit dhe nuk kanë qenë në politikë kurrë në jetën e tyre, siç po them që edhe ne nuk mund të shkojmë kurrë. Ky është dallimi që them unë. Prandaj shikoj gishtat dhe them jo, këta njerëz janë këtu, por nuk mund të shkojnë në gjyqësor. Ky është diskutimi për këtë çështje, Ulsi, që të jesh i qartë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Nuk është e thënë të jeni i qartë dhe s’do të jeni kurrë i qartë pas gjithë kësaj. Të garantoj edhe unë.

Zonja Tabaku, ju lutem!

Jorida Tabaku – Do të flas shkurt dhe në ndryshim nga kolegët nuk më pëlqen të flasim në emër të të gjithë shqiptarëve këtu, secili përfaqëson forcën e vet politike. Ka një ndryshim shumë të madh filozofik nga ajo që po diskutojmë ne, dhe ajo që po diskutoni, sepse u bë diskutimi sot vetëm për ekspertët. Sigurisht që për ne është një çështje shumë e rëndësishme dhe ideologjike që në gjyqësor (të paktën edhe në personat që po ngrenë këtë sistem dhe sugjerojnë për këtë sistem), të kemi persona, që janë përfshirë në gjykime të krimeve, të cilat për ne konsiderohen shumë të rëndësishme. Për ta pastruar gjyqësorin një herë e përgjithmonë, unë besoj se nuk mund të kemi bazë Kushtetutën e vitit 1976 dhe për këtë bien dakord të gjithë. Edhe kolegët tanë nuk është se kishin ndonjë objeksion për ekspertët, të cilët mund të jenë ekspertë

shumë të mirë, por vendosin në pikëpyetje një element që është shumë i rëndësishëm dhe është edhe një nga bazat e platformës që Partia Demokratike prezantoi në lidhje me gjyqtarët.

Unë dua të them dy gjëra kryesore, se i dëgjova të gjithë kolegët që flasin për emërimet dhe shkarkime. I gjithë diskutimi i kolegëve përmbledhet në emërimet dhe shkarkime, dhe në eliminimin e të gjitha filtrave që ka sistemi deri më sot. Çfarë të keqe ka që të marrim edhe propozimet që ka bërë Partia Demokratike, propozime, të cilat ndryshe nga këto, përpiqen ta ndryshojnë sistemin, sepse në pjesën më të madhe të rasteve e heqin kapjen politike, sepse kërkojnë një konsensus pak më të gjerë se ai që keni vendosur ju, dhe propozimet tona mendojmë që ndoshta mund të eliminojnë të gjitha ato probleme që kanë edhe ndryshimet e vitit 2008, edhe Kushtetuta, që zoti Majko dhe zoti Braho, kanë krijuar që ne nuk morëm pjesë në vitin e famshëm kur kërkuam referendum. Pra, kërkojmë që, të gjitha propozimet tona paralelisht me tuajat të diskutohen. Për këtë arsye kërkojmë edhe ndryshimin e pikës 2 të rendit të ditës, që të mos dërgohen pranë Komisionit të Venecias vetëm propozimet tuaja, po të dërgohen paralelisht me propozimet e grupit të ekspertëve, që siç u sqarua nga të gjitha palët, janë ekspert të nivelit të lartë të opozitës. Unë nuk besoj se ka ndonjë gjë të keqe këtu kur biem të gjithë dakord që do të votohet me votat e të dyja palëve.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord! Zoti Ristani keni fjalën.

Arben Ristani – Ne bëmë një kërkesë që unë besoj se e shprehëm qartë, por, nga ana tjetër, u konfundua diçka nga folësit e maxhorancës. Prandaj më duhet ta theksoj edhe një herë. Kemi rënë dakord që materialin do t'ia çojmë Komisionit të Venecias. Ne pretendojmë dhe Partia Demokratike pretendon që në Komisionin e Venecias të mos shkojë vetëm drafti i bërë nga ju, por edhe vërejtjet që ne kemi për draftin dhe të shqyrtohen së bashku në komision.

Për t'i përpiluar këto vërejtje, për të dhënë një mendim për këtë draft (sepse përndryshe nuk ishte e nevojshme që të ishim edhe ne këtu), jemi edhe ne këtu që të japim një mendim mbi këtë draft që kanë përgatitur disa ekspertë. Që të japim një mendim, unë ju them, dhe është shumë e rëndësishme, se nuk mjafton vetëm dita e shtunë dhe e dielë. Nuk keni pse të na vendosni në këtë lloj morse. Çfarë ju kushton të prisni? Nuk po flas për zvarritje, por për kohën normale. Çdo njeri kupton që është shumë e pamjaftueshme vetëm e shtuna dhe e diela. Na duhet të bëjmë disa vërejtje mbi draftin, bashkëngjitjani draftit edhe vërejtjet tona dhe çojini në Komision e Venecias. Nuk ka asgjë të keqe në këtë mes! Pse nuk na e jepni këtë kohë? Këtë po kërkojmë. Pastaj, pse jemi paragjykses ndaj ekspertëve? Një shembull e dha zoti Strazimiri nuk

na duket e moralshme, e drejtë që ata që kanë bërë Kushtetutën e Enver Hoxhës të bëjnë edhe Kushtetutën e demokracisë. Nuk na duket e drejtë, këtë mendim kemi. Nuk më duket mua e drejtë që në Kushtetutë të përcaktosh edhe rrogat e komisionerëve. Jo po t'u caktojmë edhe zyrën me Kushtetutë! Nuk ka ku të shkojë ky lloj koncepti.

Ç'do të thotë të përcaktosh rrogat me Kushtetutë? Është gabim, zotëri! Unë kapa këtë, se këtë munda të kapë. Ka edhe vërejtje të tjera, sigurisht, por kjo është më e dukshme dhe më e prekshme edhe për ata që na dëgjojnë.

Ç'janë këta ekspertë që caktojnë rrogat me Kushtetutë? Dhe çfarë rroge, rrogë që është trefishi i rrogës së Presidentit. Bëjnë edhe rrogën trefish nga Presidenti i Republikës që presupozohet që është rroga më e lartë në hierarkinë në këtë Republikë. Jo po t'u caktojmë edhe zyrat, edhe divanet në zyrë me Kushtetutë. Këto janë elementet që unë them se jeni gabim në këtë rrugë. Na jepni kohë që të bëjmë vërejtjet tona dhe të gjitha së bashku t'i çojmë atje ku kemi rënë dakord për t'i çuar.

Fatmir Xhafaj – Po, edhe ju dakord!

Spartak Braho – Meqenëse kthesa u mor 180 gradë ta mbyllim tani.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord. Ka gjë tjetër? Nuk ka.

Nga të ftuarit ka ndonjë koment të fundit? Nëse dëshironi, nuk jeni të detyruar, por nëse dëshironi! Në rregull.

Besoj se më takon edhe mua t'i them nja dy fjalë edhe për ta përmbyllur, sipas rregullit dhe zakonisht të precedentëve të punës së komisionit, por do të përpiqem të flas shkurt.

Të jem i sinqertë nuk e kisha pritur që të kishte një diskutim ideologjik në këtë komision dhe i frymëzuar nga ideologjizma dhe pozicione partiake. Kjo ishte gjëja e fundit që kisha menduar, që mund të kishte në një diskutim parlamentar dhe në një diskutim për disa amendamente kushtetuese.

Unë e kam kuptuar gjithmonë që politika shqiptare është bërë pis, sepse balta ka qenë instrumenti më kryesor që kemi dashur dhe që kemi përdorur për të bërë politikë, por nuk e kam kuptuar dhe nuk do ta kuptoj dot kurrë se si mund të përdoret e njëjta gjuhë e vjetër në diskutim mbi një draft ekspertësh. Nuk e kam kuptuar dhe nuk kam dashur ta kuptoj këtë lloj gjuhe, që përdoret në mjediset politike, por nuk do ta pranoja kurrë që kjo lloj gjuhe të përdoret kur diskutohet mbi një dokument ekspertësh. Kjo është shprehja e një politike të vjetër, që nuk ndahet dot nga politika baltës.

Ne këtu ishim thirrur për të diskutuar për një dokument dhe jo për disa individë. Ky diskutim u kthye nga një gjykim për dokumentin në një gjykim për individët. Dhe kulmi i turpërimit shqiptar, kulmi i servilizmit politik ishte: Çfarë është bërë mirë, e kanë bërë të huajt; çfarë është bërë keq e kanë bërë shqiptarët! Kjo është e turpshme! Ne duhet të jemi krenarë, që kemi ekspertë shqiptarë. Ne duhet të jemi krenarë dhe ta lëmë mënjane servilizmin politik për ekspertët tanë, të cilët edhe këta që janë këtu janë profesorë të fëmijëve tanë, tuaj dhe të disave që jeni ulur në këtë tavolinë. Janë mësuesit tuaj, keni pranuar të shkolloheni me mendjen e tyre, keni pranuar të shkolloheni me librat e tyre, keni pranuar të shkolloheni me leksionet e tyre. Sot i kryqëzoni ata për të vetmen arsye, sepse nuk janë në rreshtin tuaj.

Unë mendoj që kjo ju bën nder atyre. Kush janë ekspertët shqiptarë? Kush i ka sjellë ekspertët shqiptarë? I ka sjellë Gjykata e Lartë, ka firmosur poshtë kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori. Askush nuk e beson që zoti Zaganjori është një njeri politik ose së paku, që është pjesë e maxhorancës; i ka sjellë prokurori i Përgjithshëm, zoti Adriatik Llalla, me firmën e tij. Askush nuk e mendon që zoti Llalla është eksponent apo prokuror i Partisë Socialiste. Janë përfaqësues të firmosur nga këta njerëz. Po të dëshironi, vazhdojmë! Sapo solli Presidenti i Republikës, me vonesë, por solli dy ekspertë të nivelit të lartë. Askush në këtë vend nuk e beson që zoti Bujar Nishani është eksponent i Partisë Socialiste, edhe më i marri në këtë vend nuk do të guxonte ta mendonte këtë gjë.

Vazhdojmë më tej. Janë ekspertë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, pedagogë të nderuar. I ka sjellë Universiteti Shtetëror i Tiranës. Rektori i atij universiteti, të cilin nuk e kanë dominuar. Është autonom dhe i pavarur, thoni ju. Ai ka sjellë përfaqësuesit e Universitetit Shtetëror të Tiranës, këtu. Vazhdojmë më tej. Janë përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk është Dhoma e Partisë e Socialiste e kështu me radhë.

Të gjithë ata janë përfaqësues të insioneve të sistemit të drejtësisë, por kjo është historia e vjetër në këtë vend, i dhunës mbi institucionet, i presionit mbi institucionet, i presionit mbi njerëzit, që guxojnë të kenë mendjen dhe mendimin e tyre në këtë vend. Në këtë vend mund të kesh të drejtë vetëm po të jesh në një parti politike, vetëm po të kesh dalë në një parti politike, që më në fund të jesh i pavarur.

Unë nuk dua t'i hyj, se nuk është në zakonin tim, po të marrim se cilët janë ekspertët e Partisë Demokratike, por është e drejtë e tyre. Unë kam rezervat e mia mbi përkatësinë politike të ekspertëve që kanë sjellë. Të pastër, katër prej tyre janë ish-deputetë të Partisë Demokratike dhe mendimet e tyre janë kaq të vyera, saqë duhet t'u nënshtrohemi ne të tjerët, kurse mendimet e këtyre ekspertëve nuk duhet t'i llogarisin, se nuk na paskan lindur në një datë me Partinë Demokratike. Por bota nuk filloi të rrotullohet dhe nuk rrotullohet sipas Partisë Demokratike apo sipas Partisë Socialiste ku unë bëj pjesë dhe, zaten, kjo drejtësi në këtë vend është pikërisht se e ka rrotulluar politika.

Sot ka ardhur një moment historik: të bëjmë drejtësinë, por drejtësinë nuk mund ta bëjë politika dhe nuk ka sesi ta bëjë politika, sepse politika e ka mbajtur peng drejtësinë në gjithë këto vite, politika e ka lënë të korruptuar dhe e ka ushqyer korrupsionin e drejtësisë në këtë vend. Prandaj po kërkohet të ndryshohet dhe këtë e kërkojnë shqiptarët.

Nëse nuk u bindin këto drafte, këto dokumente, atëherë po i sfidojmë: le të dalim, le ta thonë përpara qytetarëve të këtij vendi, dhe ta shprehin qytetarët e këtij vendi sesi e duan drejtësinë dhe nga kush e presin drejtësinë, nga Partia Demokratike, apo nga profesionistët e këtij vendi? Unë jam i bindur që nuk e presin as nga Partia Demokratike, as nga Partia Socialiste, por nga njerëzit profesionistë të këtij vendi.

Është e dhimbshme pjesa e mungesës së respektit për tëndin, e mungesës së respektit për të mençurin, e mungesës së respektit për të zotin, por unë mendoj se nuk është e rëndësishme ta fokusojmë debatin këtu; e rëndësishme është të fokusohemi te dokumenti që ka ardhur.

Unë dëshiroj t'ju jap komplimentet e mia, zonja dhe zotërinj ekspertë,

Nuk po ju ndaj shqiptarë dhe të huaj, por po ju them ekspertë që keni punuar; për mua jeni njësoj.

Ky është një dokument i mirë. Natyrisht, edhe unë mund të kem komente, sugjerime dhe pikëpyetje ndaj tij, sepse ju e thatë, me të drejtë, që ky është një draft i parë mbi të cilin do të ndërtohet një proces, por ama dy gjëra të mira i ka ky projekt për atë që ka sy për të lexuar dhe mend për të kuptuar: e ndan politikën përfundimisht nga drejtësia, e largon politikën nga ndikimi i drejtpërdrejtë në sistemin e drejtësisë.

Së dyti, e bën drejtësinë llogaridhënëse dhe të aftë për t'u vetëpastruar nga njerëzit e paaftë dhe të korruptuar që ka brenda sistemit.

Do të mjaftonin këto dy risi ose do të mjaftonin këto dy tipare të këtij dokumenti, që unë ta votoja këtë dokument pa asnjë mëdyshje. Natyrisht, nuk ka kushtetutë të përkryer, siç nuk ka edhe ligje të përkryera, por ka njerëz, të cilët i kuptojnë apo i zbatojnë keq ato. Dokumenti që kemi këtu është një hap i parë.

Çfarë po kërkohet në thelb, se dua ta sqaroj edhe për gazetarët në mënyrë të veçantë, që e përcjellin këtë në opinionin publik? Ky nuk është një dokument i maxhorancës. Maxhoranca e ka marrë këtë dokument, po edhe opozita, ditën e premte. Ky nuk është një dokument i hartuar nga njerëzit e maxhorancës, sikundër nuk është edhe një dokument i hartuar nga njerëzit e opozitës, pa dyshim, por është hartuar nga ekspertët dhe, siç e deklaruan ata vetë, janë të gjithë, po e quaj, bashkëhartues në këtë dokument. Njëri prej tyre, me shumë të drejtë tha, në mos gaboj, se kjo është një punë e përbashkët e të gjithë këtij ekipi dhe ne shohim çdo gjë që mendojmë të reflektuar në këtë dokument. Më qartë se kaq, edhe ata, që ju i quani dhe i ndani në ndërkombëtarë dhe në shqiptarë, nuk mund t'jua thoshin siç jua thanë sot.

Po çfarë kërkojnë këta? Kanë ardhur dhe thonë: “Ne kemi bërë një analizë dhe një strategji, e cila ka vend për diskutim, pavarësisht se ju e bojkotuat miratimit e saj, dhe mbi këtë dokument tani kemi përgatitur një projekt amendamentesh, për të cilat, përpara se t'jua sjellim në një qëndrim final, kërkojmë një opinion të Komisionit të Venecias, në mënyrë që ta shohim këtë qasje me standardet ndërkombëtare, por nga ana tjetër edhe për t'jua shkurtuar kohën e debatit shterpë ju parlamentarëve”. Më duket një kërkesë shumë e arsyeshme, e cila pajtohet me disa deklarime politike të maxhorancës dhe të opozitës që, përveç ekspertëve euro-amerikanë, do të ishin ekspertët e Komisionit të Venecias që do ta certifikonin këtë standard. Ata kanë ardhur dhe e kanë sjellë këtu.

Zoti Ristani tha: “Pse na mblodhët ne?”. Sepse unë nuk di ndonjë mënyrë tjetër sesi mund të shkonte drejtpërsëdrejti në Venecia pa kaluar kjo nga komisioni dhe pa kaluar nga Kryetari i Kuvendit, sepse do një kërkesë zyrtare.

Ata erdhën dhe thanë: “Ne duam ta marrim mendimin e Komisionit të Venecias, por nuk kemi mënyrë tjetër përveç kësaj veshjeje juridiko-formale parlamentare. Nuk mund t'i drejtohem drejtpërsëdrejti Venecias. Prandaj, ju lutem, zonja dhe zotërinj, të nderuar deputetë, na mundësoni që këtë dokument t'ia çojmë Komisionit të Venecias dhe të na japë një opinion, në pamundësi që t'i drejtohem drejtpërsëdrejti”. Ne këtë gjë po bëjmë, po u japim atyre mundësinë

që t'i drejtohen Komisionit të Venecias dhe ajo që unë ju ftoj për të votuar është që t'ia kalojmë këtë dokument Komisionit të Venecias.

Ndërkohë, duke respektuar të gjitha sensibilitetet, pavarësisht se unë personalisht vetë jam kundër me këtë lloj qasjeje, por duke respektuar rregullat e lojës, u kërkoj subjekteve përfaqësuese të forcave politike, që kanë një koment shtesë mbi dokumentin e ekspertëve, ta përgatisin brenda ditës së premtë për t'ia përcjellë në paketën e madhe Komisionit të Venecias. Ky dokument do të miratohet sot dhe nesër do t'i shkojë Komisionit të Venecias dhe ditën e premtë e gjithë paketa zyrtare së bashku me këtë, do t'i shkojë Komisionit të Venecias.

Kush është dakord me këtë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kush është kundër?

Eduard Halimi – Ne jemi kundër të gjithë procesit dhe ti po e prish të gjithë procesin dhe të gjithë konsensusin për këtë proces.

Fatmir Xhafaj – Pse? Ne po e votojmë. Çfarë do tjetër? Do ta kaloj sot dhe deri të premtetn do të sjellin komentet.

Eduard Halimi – Ky dokument mund të votohet për procedurë. Mos e prish konsensusin! Je fajtor për prishjen e konsensusit.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Për fat të mirë, i ke këtu mediet.

Eduard Halimi – Je fajtor për prishjen e konsensusit.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Do ta votosh, apo jo?

Eduard Halimi – Prit ta dërgojmë të hënën, së bashku me të gjitha komentet tona dhe të shkojë si paketë drafti i përgatitur nga ekspertët, siç e mendojnë ata. Sipas mendimit tënd është i shkëlqyer, ndërsa sipas meje, shkon në pjesën më të madhe drejt kapjes dhe krijimit të Edi Ramës, sulltan.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Nuk e dija që edhe euro-amerikanët, që i ke lavdëruar ti, do t'i shërbejnë Ramës.

Eduard Halimi - Po të them të presësh që ta dërgojmë të hënën, së bashku me të gjitha komentet tona dhe të shkojë si paketë e përbashkët. Nuk ke pse e prish në këtë moment konsensusin. Të arrihet të jepet produkti i opozitës dhe të shkojë bashkë atje. Nuk ka nevojë të mblidhemi më ne. Shkresa e ekspertëve të hënën do të jetë këtu, në Kuvend. Atë ditë, së

bashku me draftin e përgatitur nga ju dhe nga ekspertët tuaj, të shkojë të shqyrtohet në Komisionin e Venecias.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Po ta shpjegoj edhe një herë.

Eduard Halimi – Unë po të them një gjë të fundit, Fatmir.

Fatmir Xhafaj – Mirë është që për etikë, të dish të drejtolesh.

Eduard Halimi – Zoti Xhafaj,

Ky është një proces i gjatë, që do durim. Është mirë të jesh i duruar dhe po të ketë sa më pak protagonizëm politik, si ai që shprehe më parë, i bën më mirë procesit. Ta them shumë sinqerisht këtë. Sa më pak arrogancë në momentin e trajtimit të çështjeve procedurale, aq më mirë i bën procesit. Arroganca me caktimin me urgjencë të mbledhjes, arroganca e shqyrtimit me urgjencë, arroganca që nuk e lë të hënën, por e do të premtën apo që nuk e do të premtën, por e do tani, e do patjetër sot, të gjitha këto nuk i shërbejnë një procesi kaq të rëndësishëm.

Diku mund të ndahemi, por për procesin, po të kërkoj edhe një herë, edhe pas diskutimeve të gjata që patëm sot me partnerët ndërkombëtarë, të tregohesh i matur, i duruar dhe të lësh prepotencën, se nuk i bën mirë procesit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Unë kisha parë arrogancë të maxhorancës, po maxhorancë të opozitës vetëm ju mund të doni ta kenë. Po ju aq jeni dhe nuk mund t'i shtoni më shumë numrat. Unë kurrë nuk e kam parë këtë si çështje numrash dhe po jua them këtë. Ju e dini shumë mirë që kam bërë lëshim pas lëshimi, edhe në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, për të bërë përfaqësimin e opozitës këtu.

Atë që votova dhe që do ta votoj pa asnjë mëdyshje, është fakti që sot t'i jepet rrugë kësaj kërkesë dhe këtij dokumenti për të shkuar në Komisionin e Venecias.

Nesër, në mënyrë elektronike, do të njoftohet në Komisioni i Venecias, për të kapur datën e tetorit për Komisionin e Venecias. Priten edhe komentet tuaja dhe do të çohet në rrugë postare, e gjitha bashkë.

Ti, si gjithmonë, dëgjon vetëm atë që ke në kokë, siç bërë radhën e parë që ike, pa kuptuar se çfarë po votohej. Edhe sot jam shumë i bindur, se do ta kuptosh kur të dalësh jashtë.

Po jua sqaroj edhe një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Të lutem!

Po ju them se dokumenti do t'i shkojë në mënyrë elektronike Komisionit të Venecias, për ta vënë në dijeni që ky është dokumenti që kemi miratuar. Në rrugë zyrtare do të shkojë dokumenti me të gjitha propozimet që mund të vijnë nga PD-ja, nga PS-ja, nga LSI-ja dhe çdo nga çdo grup tjetër parlamentar, që çmon se mund të bëjë një koment mbi këtë dokument, pavarësisht se kjo nuk është në qasjen time, është pjesë e rregullave dhe e lojës politike, të cilën e keni pranuar dhe po kërkoni ta luani kështu. Kështu le të luhet, megjithëse mendoj se nuk është shumë pozitive, por e respektova këtë jashtë bindjes sime dhe po them se do të bëhet në këtë mënyrë. Kështu edhe afatin e nevojshëm të Komisionit të Venecias e kapim dhe të gjitha dokumentet: dokumenti bazë *hard copy*, së bashku me pjesën e dokumenteve të tjera, i shkon në një paketë zyrtare Komisionit të Venecias. Kaq kisha.

A do ta votoni këtë zgjidhje?

Eduard Halimi – Shkruaje vendimin si e ke dhe më pas vendosim, sepse edhe herën e kaluar me ekspertët, nuk u tregove...

Fatmir Xhafaj – Për pikën e tretë të rendit të ditës, jemi dakord me projektvendimin për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm deri më 30 Qershor 2016?

Dakord. Miratohet. E mbyllim këtu.

Faleminderit!

Natën e mirë!

Unë e di që sa më shumë rri ti, aq më shumë reflekton. Ti e kupton gjithmonë 24 orë me vonesë.

MBLEDHJA MBYLLET